



**Instrumenti i Bashkimit Evropian
për Ndhinë Paraaduese – IPA**



PROJEKTE PËR NXITJEN PËRFSHIRJES SOCIALE



Ky projekt është financuar nga
Bashkimi Evropian



Titulli origjinal: Projekte Për Inkurajimin e

Përfshirjes Sociale

Autori: Maria Marinakou

Botues: Kongresen Servisen Centar, Shkup, 2017

Redaktor: Zorica Teofilova

Ligjërues: Vesna Kostovska

Përgatitjen kompjuterike: Zoran M. Gulevski

Print: Vinsent Grafika

Blagoja Stefkovski, 16

1000, Shkup. Maqedoni

Tirazhi: 200

CIP - Katalogizacija vo publikacija

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

352:364(497.7)

MARINAKOU, Maria

Projekte për inkurajimin e përfshirjes sociale / Maria Marinakou ; [përktheu Eniena Aeti].

- Shkup : Bashkëpunëtor i përkushtuar, 2017. - 131 стр. : граф. прикази ; 30 см

ISBN 978-608-4780-83-0

а) Локална самоуправа - Социјална заштита - Македонија б) Социјална инклузија

COBISS.MK-ID 105203722

VËREJTJE

Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbytja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e AECOM International Development Europe dhe partnerëve të konzorciumit të saj dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Bashkimit Evropian.

Shkup, nëntor 2017



Znj. MILLA CAROVSKA, Ministre e Punës dhe Politikës Sociale

Përfshirja sociale dhe aktivizimi i qytetarëve të cilët janë në rrezik social dhe të cilët gjenden më larg tregut të punës, ishin në fokusin e projekteve të bashkë financuara nga Bashkimi Evropian në kuadër të ndihmës para aderuese. Komponenti 4 i ndihmës paraaderuese "Zhvillimi i resurseve njerëzore"; gjatë 5 viteve të kaluara, me anë të aktiviteteve të shumta, të realizuara nëpërmjet 48 grant projekteve", krijoi mundësi të motivohen mbi 2500 persona në rrezik social, ti përmirësojnë shkathtësitë e tyre përpunësim, të kyçen në trajnime për zanate, të aktivizohen, të fitojnë përvojë pune dhe shkathtësi pune dhe të kenë qasje më të lehtë në tregun e punës. Dua të theksoj se këto projekte në veçanti kontribuuan drejt identifikimit të rëndësisë së "integritit në tregun e punës"; gjatë procesit të përfshirjes sociale. Zhvillimi dhe zbatimi i modelit të përshtatur ndaj nevojave të personave në rrezik social me aktivitete konkrete në nivel lokal, dhe në bashkëpunim ndërmjet aktorëve kryesor të sektorit qeveritar, qytetar dhe privat, krijoi infrastrukturë bazë, modeste, por të rëndësishme, për mbështetjen e ardhshme në aktivizimin e kategorive të rrezikuara të qytetarëve në tregun e punës dhe në gjithë procesin e përfshirjes sociale dhe sistemit të mbrojtjes sociale. Duke ju falënderuar këtyre projekteve të realizuara nga sektori civil në vendin tonë, organizata nga vende të tjera anëtare të BE-së dhe numër i caktuar i institucioneve publike, u formuan numër i madh i partneriteteve lokale dhe u mundësua qasje participative në sigurimin e mbështetjes, motivimit, trajnime dhe mundësi përpjesë marrje në tregun e punës. Këto organizata dhe partneritete janë pionierë në implementimin e projekteve për punësim dhe përfshirjen sociale në vendin tonë sipas shembullit të projekteve që financohen nga Fondi Evropian Social, në vendet e BE-së. Në afat të gjatë, përvoja e fituar dhe ndërtimi i kapaciteteve lokale bazohet mbi krijimin dhe implementimin e politikave më të mira dhe më efektive për punësim dhe mbrojtje sociale, por edhe për shfrytëzimin më të madh të fondeve evropiane në zgjidhjen e problemeve sociale të qytetarëve tanë. Pa dyshim, edhe përpos të gjitha investimeve, aktiviteteve të realizuara, rezultateve të arritura dhe krijimin e shembujve të mirë, ekzistojnë edhe sfida të ardhshme. Me ato do të përballohemi duke qenë konsekuent ndaj synimeve të arrihet kohezion dhe të zbatohen parimet evropiane të përfshirjes sociale. Do të vazhdojmë me fuqizimin e kapaciteteve të ofruesve jo shtetëror të shërbimeve me qëllim të mundësohet pjesëmarrja e tyre në tregun e shërbimeve sociale. Qëllimi është në mënyrë sistemore të vendoset dhe të sigurohet cilësi e lartë e shërbimeve jo institucionale për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale të cilët do tu përgjigjen nevojave reale të qytetarëve."

MILLA CAROVSKA,
Ministre e Punës dhe Politikës Sociale



z. SAMUEL ZHBOGAR, Kreu i Delegacionit të Bashkimit Evropian

Ndihma e BE-së, në kuadrin e IPA, synon të ndihmojë vendin që t'i përfundojë reformat e planifikuara të nevojshme për të fituar anëtarësimin në BE. Ky publikim është përgatitur me qëllim të paraqitjes për ta kuptuar më mirë ndihmën e ofruar nga Bashkimi Evropian. Përmban një përzgjedhje të projekteve, qëllimeve dhe rezultateve të tyre të pritura, të cilat do të kontribuojnë në përmirësimin e përfshirjes sociale në vend. Çdo projekt ose zonë e ndihmuar dhe prezantuar shoqërohet me detaje teknike dhe rezultate që ofrojnë mundësi më të mira për gruan e pa favorizuar, personat me aftësi të kufizuara, romët dhe komunitetet e tjera të marginalizuara në shoqëri. Shpresojmë që ky publikim do t'ju ndihmojë t'i përmirësoni njohuritë për çështjet specifike dhe të përgjithshme që lidhen me BE-në, si dhe për mbështetjen konkrete që u ofrohet qytetarëve të këtij vendi siç vazhdon udhëtimin drejt integritimit në BE.

SAMUEL ZHBOGAR,
Kreu i Delegacionit të Bashkimit Evropian



Parathënie

Qëllimi i kësaj broshure është të japë kuptim të qartë mbi objektivat, aktivitetet, rezultatet dhe arritjet e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian në kuadër të Skemës së Grantëve "Mbështetja e Përfshirjes Sociale" (MPS) dhe Skema e Grantit "Promovimi i përfshirjes sociale në nivel lokal" (PPSNL) të IPA komponentit IV - Zhvillimi i Burimeve Njerëzore 2007-2013.

Sipas këtyre dy Skemave të Grantit **90 organizata të ndryshme** (66 në Skemën e Grantit të MPS-së dhe 24 në Skemën e Grantëve të PPSNL-it), kanë zbatuar 38 projekte kryesisht OJQ-të (75%) dhe organizatat publike (25%). Nga 90 organizata, 72 organizata janë nacionale dhe 18 ndërkombëtare.

Shpërndarja gjeografike e skemës së granteve për "Mbështetjen e përfshirjes sociale (MPS)" tregon se nga 66 organizata, 30 janë të vendosura në kryeqytetin Shkup, 25 në pjesë të tjera të vendit dhe 11 janë organizata të huaja. Në skemën e granteve "Promovimi i përfshirjes sociale në nivel lokal" (PPSNL) nga 32 organizata të përgjithshme (8 marrin pjesë në skemat e granteve) 5 janë të vendosura jashtë Shkupit. Në hartën e mëposhtme yjet blu tregojnë organizatat udhëheqëse dhe të gjelbërit tregojnë bashkë-aplikantët.



Përfituesit e skemës së Grantit të MPS ishin mbështetur nga Projekti i Asistencës Teknike, i cili është në bashkëpunim të ngushtë me Strukturën Operative për IPA në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale. Projekti i AT, i paraqitur në mënyrë analitike në fund të broshurës, ka ofruar trajnime dhe seminare për Menaxhimin e Grantit dhe Raportimin duke përfshirë trajnimet dhe monitorimin në vendndodhje. Projekti shtesë i Asistencës Teknike i orientuar në Aspektet Financiare të Skemës së Grantit ka vepruar në kuadër të Autoritetit të Marrëveshjes së Ministrisë së Financave.


Ka pasur arritje të rëndësishme dhe ndikim afatgjatë si rezultat i zbatimit të 38 projekteve të granteve të raportuara në Broshurë. Në tërësi:

Gjithsej **2.299 persona morën pjesë në trajnimet e aftësive të buta**, 715 ishin minoritete etnike - kryesisht romë, kryesisht femra; 350 ishin persona me aftësi të kufizuara dhe të tjerë përfshinin 290




të rinj në rrezik social me shkathtësi të ulëta; të papunët afatgjatë; viktimat e dhunës në familje, prindërit e vetëm, kryesisht nëna; të burgosurit; popullata rurale, bizneset, institucionet publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, organizatat e shoqërisë civile (IP, NJVL, OSHC) etj.

Numri i përgjithshëm i personave që kanë marrë trajnim të butë



Më shumë se **2.225 persona janë trajnuar në shkathtësi të ndryshme profesionale**, duke fituar njohuri, përvojë dhe kualifikime që do të lehtësojnë hyrjen e tyre në tregun e punës. 683 ishin kryesisht gra rome dhe nga minoritetet e tjera etnike (është e rëndësishme të përmendet se 16 nga 38 projektet kanë synuar veçanërisht komunitetin rom), 647 ishin persona me aftësi të kufizuara dhe 464 ishin të rinj të papunë në rrezik varfërie dhe përjashtimi.


Numri i përgjithshëm i personave që kanë marrë trajnim profesional



Janë organizuar **200 kurse trajnimi** dhe janë përpiluar **45 module trajnimi**, duke ofruar një bazë të shëndoshë për aftësimin dhe ri-aftësimin e grupeve të cenatura që përballen me marginalizimin dhe shumë pengesa dhe kërcënime në përpjekjet e tyre për të hyrë në tregun e punës.


38 projektet e granteve përdorën shumë metoda të ndryshme dhe vegla të ndryshme në sigurimin e aftësive dhe rritjen e punësueshmërisë së target grupeve të tyre. Përveç aftësive të buta dhe trajnimit profesional, ata gjithashtu vendosën 687 persona në mentorim, stazh, praktikë dhe trajnime në vendin e punës, nga të cilët grupet kryesore ishin 185 gra rome dhe minoritete të tjera etnike, 153 persona me aftësi të kufizuara dhe 157 të rinj të papunë në rrezik varfërie dhe përjashtimi.

Numri i përgjithshëm i personave të cilët ishin të vendosur në mentorim / stazh / praktikë / trajnime në vendin e punës



Tashmë janë siguruar **128 vende pune** dhe pritet më shumë pasi që skema e tretë e Grantit është ende funksionale deri në dhjetor 2017. Një numër shumë i rëndësishëm i 2.200 përfituesve të projekteve të granteve që morën pjesë në trajnimet për aftësitë e buta dhe trajnimet profesionale u ishte lehtësuar për të aplikuar për masat aktive të punësimit të operuara nga Agjencia për Punësim dhe në të ardhmen e afërt do të sigurohen pozitave të mëtejshme të punësimit.

Numri i përgjithshëm i personave që janë punësuar



Sidoqoftë, përpjekjet për t'i rritur mundësitë e punësimit në shumë projekte janë në vazhdim, pasi ata i kanë mbështetur shërbimet e tyre.

Janë zhvilluar **480 plane vetëpunësimi personale / karriere / biznese** për/ dhe me përfituesit (individët dhe autoritetet lokale) të lehtësuara nga profesionistët social dhe ekspertët që punojnë në 90 organizatat të cilat i kanë zbatuar projektet.

Gjithsej **129 persona janë trajnuar si Trajnerë** dhe janë **botuar 53 studime**. Janë organizuar më shumë se **65 nisma dhe konferenca përfundimtare**.

Përtej rezultateve të rëndësishme të raportuara dhe të paraqitura në këtë broshurë, përtej indikatorëve, vlera e shtuar dhe ndikimi afatgjatë që kanë arritur 38 projektet, janë përvojat e ndryshimit të jetës reale që **kanë demonstruar dëshmitë e përbashkëta nga përfituesit e projektit, përdoruesit dhe palët e interesuara**.

Është në fjalët dhe veprimet e tyre që matet vlera reale e projekteve të prezantuara.

Një nga dëshmitë e shumta të përfituesve të këtyre projekteve jep një pasqyrë të fuqishme të ndryshimeve jetësore të arritura:

"Jam një prind i vetëm i dy fëmijëve të mitur, të moshës pesë dhe shtatë vjeç. Vendimi më i vështirë në jetën time ishte të heqja dorë nga kujdesi i fëmijëve të mi dhe për shkak të situatës së vështirë ekonomike, t'i vendosja ata për t'u kujdesur me organizatën 'Fshati i fëmijëve SOS'.

Ky projekt më ndihmoi të rimarrë kujdestarinë e fëmijëve të mi dhe t'i përfshij në sistemin arsimor, duke ndjekur mësimet e rregullta shkollore. Hapi i dytë i rëndësishëm që mora për të përmirësuar jetën time ishte vendimi të punoja në veten time dhe vazhdoja arsimin, kështu, duke forcuar mundësitë për punësim. Për këtë qëllim, ju bashkova ciklit të trajnimeve të ofruar nga ky projekt. Kjo mundësi ishte shumë e rëndësishme për mua, kështu që u solla në një mënyrë shumë pozitive dhe fitova vetëbesim. Në fazën e dytë, pata mundësinë për një trajnim / praktikë në vend të punës si mjeshtër suvaje. Drejtori i kompanisë ishte më se i kënaqur me performancën time të punës dhe qëndrimin ndaj punës. Kjo është arsyeja pse, pas përfundimit të trajnimit, ai më ofroi punë për t'u punësuar rregullisht si mjeshtër suvaje.

Në fund, falë mundësisë që më është dhënë, historia ime e trishtuar e jetës u transformua me sukses në një fund të lumtur, një histori plot perspektivë, për të cilën vlen të jetosh dhe të jetohet. Kam arritur të bëhem narrativ i historisë së re të jetës sime, një tregim jete me shpresë që premtton kushte më të mira jetese për mua dhe për fëmijët e mi".

(Fadilj Emin, përfitues i projektit)

Maria Marinakou

Udhëheqëse e Ekipit / Eksperte e Lartë

Projekti "Asistencë Teknike në Menaxhimin e Projekteve dhe Monitorimin e Skemës së Grantit"
Mbështetja e Përfshirjes Sociale "

Nxitja e përfshirjes sociale të personave të pa favorizuar në tregun e punës

VEPRO PËR KONKURRENCË MË TË MIRË NË TREGUN E PUNËS

Numri identifikues.: EuropeAid/135012/M/ACT/MK

Nr. i kontratës.: 12-9124/1

Kohëzgjatja: 20 muaj

Periudha: 14.12.2015 – 14.08.2017

Fusha e politikave: Përfshirja sociale

Nën fusha e politikave: Nxitja e përfshirjes sociale të personave të pa favorizuar në tregun e punës

Buxheti: 199,990.32 EUR

Kontributi i BE-së 189,990.32 EUR

Qëllimi i Përgjithshëm:

Kontribut për rritjen e pjesëmarrjes së njerëzve të ekspozuar ndaj rrezikut social dhe personave të përjashtuar social nga tregu i punës për uljen e shkallës së papunësisë në vend.

Qëllimet Specifike:

- 1. Të promovon kushtet dhe mundësitë për punësimin e:
o Persona të ekspozuar në rreziqe sociale dhe
o Persona të papunësuar për një kohë të gjatë*



EU
for
YOU

Target Grupet / Përfituesit:

35 persona të ekspozuar ndaj rreziqeve sociale dhe të papunësuar për një periudhë më të gjatë kohore.

Lokacioni i Veprimit:

Komunat e Shkupit, Gjorçe Petrov, Gazi Baba dhe Kisella Voda.



- 1: Sigurim i mbështetjes psiko-sociale; 2: Punëtori për aftësi të buta; 3: Psikoterapi Gestalt;*
- 4: Ndërtimi i ekipit; 5: Provimi përfundimtar për trajnimin artizanal.*

Rezultate & Aktivitete të Zbatuara:

- 1. Ngritja e kapaciteteve për zhvillimin personal dhe zhvillimin e përfituesve të ndihmës sociale:**
 - Përzgjedhja e përfituesve, punëtori për promovimin e aftësive sociale, planet individuale të veprimit, psiko -terapi të Gestalt-it.
- 2. Aftësitë dhe njohuritë e zhvilluara profesionale të përfituesve të ndihmës sociale:**
 - Punëtori me përfituesit, vizitat e artizanëve, përzgjedhjes së artizanaleve dhe trajnimet , punëtori me anëtarët e Dhomës së Zejtarëve.
- 3. Rritja e mbështetjes për familjet për përfshirjen aktive të përfituesve në këtë proces:**
 - Punëtori me ekipet e punonjësve socialë, ofrimi i shërbimeve sociale për familjet.
- 4. Bashkëpunim i përmirësuar midis Kryqit të Kuq, institucioneve qeveritare, vetëqeverisjeve lokale dhe sektorit civil dhe zejtar në fushën e promovimit të përfshirjes sociale të përfituesve në tregun e punës:**
 - Takimet fillestare me palët e interesuara lokale, tryezat e rumbullakëta publike, punëtoritë përfundimtare.



1 & 2: Fotografi nga takimi i parë me përfituesit; 3: Punëtori me anëtarët e Odës së Zejtarëve;
4: Trajnim për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës; 5: Monitorimi i trajnimit në zejtari - kuzhinier; 6: Punëtoritë finale.

Outputet Kryesore / Rezultatet:

1. Fletushkë për promovimin e aktiviteteve të realizuara në kuadër të projektit.

- <http://ckrm.org.mk/publikacii-cat/edu-info-materijali/>
- <http://ckrm.org.mk/al/publikacii-cat/material-edukativo-informativ/>

Treguesit Kryesorë:

- 1. 35 persona në rrezik social me status të papunësuar për afat të gjatë kohor nga Gazi Baba, Kisela Voda Gjorçe Petrov kanë përfituar nga trajnimet për forcimin e kapaciteteve të tyre që të jenë më konkurrues më të mirë në tregun e punës.**
 - Target: 40, Arritja 35 (85.5%)
- 2. 48 persona në rrezik social me status të papunësuar për afat të gjatë kohor nga Gazi Baba, Kisela Voda Gjorçe Petrov kanë fituar aftësi sociale.**
 - Target: 40 Arritja 48 (120%)
- 3. Ofroi shërbime psikologjike dhe sociale për 35 familjet të përfituesve nga Gazi Baba, Kisela Vodë dhe Gjorçe Petrov.**
 - Target 40. Arritja 33 (82.5%)
- 4. 100 pjesëmarrës ishin prezent në 3 tryeza të rumbullakëta publike, me temë "Mundësitë dhe Sfidat për Punësimin e Personave të Cenuar".**
 - Target 40. Arritja 35 (85.5%).
- 5. 70 pjesëmarrës morën pjesë në tryezën e 3-të të rumbullakët me temë "Mundësitë e punësimit dhe Sfidat për njerëzit në nevojë"**
 - Target 100. Arritja : 70 (70%).

Qëndrueshmëria:

1. *Pas mbështetjes nga Bashkimi Evropian, aktivitetet pasuese janë parashikuar në disa drejtime. Një pjesë shumë e rëndësishme është se koordinatori lokal dhe ekipi i punonjësve socialë nga Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit do të vazhdojnë të punojnë në përkrahjen e përfituesve që përfshin takime të rregullta, ndjekjen e aktiviteteve të ndërmarra në planin individual të karrierës, këshilla dhe informacione mbi zbatimin e planit të karrierës dhe të gjithë mbështetjen e nevojshme për të cilat do të ketë nevojë përfituesi për punësim të suksesshëm.*
2. *Gjithashtu ata do të punojnë në projekt për integrimin në punë të personave të pastrehë që mbështetet nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Ky projekt do të matë punësimin dhe gatishmërinë për ndryshimin e përfituesit në Qendrën për të pastrehët "Çicino Sello" dhe do të jetë një bazë për krijimin e programeve për integrimin e punës të këtij grupi të synuar.*
3. *Gjatë periudhës së ardhshme, ekipi do të punojë në zhvillimin e Dyqanit të dorës së dytë, si një ndërmarrje sociale që do të angazhojë dy rrobaqepësit që përfunduan artizanat brenda këtij projekti. Ata do të bëjnë praktikën atje, përmes aktiviteteve për riparimin e pëlhurave dhe riciklim.*




Tri tryeza të rrumbullakëta publike u organizuan në komunitet Gjoçe Petrov, Kisella Vodë dhe Gazi Babë, për të ndarë rezultatet nga projekti dhe për të diskutuar për promovimin e kushteve dhe mundësive për punësim dhe zvogëlimin e papunësisë së personave nga familje të rrezikuara sociale.

"Një nga problemet kryesore që u adresuan nga projekti është tejkalimi i barrierave të stigmatizimit dhe paragjykit me të cilat grupet e pambrojtura zakonisht ballafaqohen kur kërkojnë trajnime dhe shërbime për punësim."

*(Kornelija Çipusheva Spasovska,
Menaxher i Projektit në SOS Fshatin e
Fëmijëve Maqedoni)*

*"Gjatë punësimit për rritjen dhe zhvillimin personal, së bashku me trajnimin për artizanat -bukëpjekës, u bëra një person krejtësisht i ndryshëm. Përgjegjëse për vendin e punës, e sigurt, komunikative. tani ndihem më e guximshme se sa isha para se të kërkoj punë, kur isha e frikësuar nga dështimi. Tani, jam e sigurt: mund të jem një person i suksesshëm
(Karolina Zdravkovska, bukëpjekëse.)"*

ORGANIZATA UDHËHEQËSE:



KRYQI I KUQ I MAQEDONISË
KOÇO RACIN 13, 1000 SHKUP
+389 2 311-4355
WWW.REDCROSS.ORG.MK

DETAJET E KONTAKTIT TË PROJEKTIT:

WWW.FACEBOOK.COM/CRVENKRSTNAREPUBLIKAMAKEDONIJA/
WWW.TWITTER.COM/MACEDONIAN_RC

ORGANIZATA PARTNERE:

Chamber of Craft – Shkup
Bitpazarska 12, 1000 Shkup
+389 2 323-7850
www.zkomora.com.mk



INICIATIVA PËR PUNËSIM RURAL

Numri identifikues.: *EuropeAid/135012/M/ACT/MK*

Fusha e politikave: *Përfshirja sociale*

Numri i kontratës.: *12-9138/1*

Nën fusha e politikave: *Nxitja e përfshirjes sociale të personave të pa favorizuar në tregun e punës*

Kohëzgjatja: *18 muaj*

Buxheti *153,776.78 EUR*

Periudha: *14.12.2015 – 14.06.2017*

Kontributi i BE-së: *146,057.19 EUR*

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM:

Të rritet punësimi i personave të pa favorizuar në mënyrë që të lehtësohet integrimi i tyre social dhe qasja në tregun e punës

QËLLIMET SPECIFIKE:

1. Të përmirësojë shkathtësitë dhe kompetencat e punësimit të personave të pa favorizuar që do të rezultojë me punësim të qëndrueshëm.
2. Të inkurajojë aktivizimin e tregut të punës përmes promovimit të rrugëve individuale për punësim.
3. Të rritet pjesëmarrja e personave të pa favorizuar në tregun e punës.

TARGET GRUPET / PËRFITUESIT:

1. Qytetarët socialë të pa favorizuar, të papunë të komunave Prilep, Krivogashtani dhe Dollneni,
2. Vetëqeverisjet lokale, Agjencia për Punësim, sektori i biznesit dhe publiku i gjerë në target komunitat.

Lokacioni i Veprimit:


Komuna e Prilepit, Krivogashtanit dhe Dolnenit.



1: Trajnim për aftësitë e buta dhe metodat e kërkimit të vendeve të punës; 2: Trajnim profesional për shoferët e mjeteve të transportit.

Rezultate & Aktivitete të Zbatuara:

- 61 persona të pa favorizuar kanë zhvilluar aftësitë e tyre profesionale dhe aftësitë për kërkimin e vendeve të punës:
 - Një aktivitet fillestar, 3 vizita në terren dhe 8 prezantime publike u organizuan për të prezantuar qëllimin dhe objektivat e projektit për publikun e gjerë dhe për target grupin,
 - U zhvilluan kritere dhe u hap një thirrje për aplikime nëpërmjet portaleve rajonale në internet, FB grupe, postera, fletushka dhe fletëpalosje, për të arritur te sa më shumë të rinj që të jetë e mundur,
 - u angazhuan 2 ekspertë, u zhvillua një modul, u shtypën manualet dhe u përfunduan me sukses 3 cikle trajnimi me aftësi të buta, që u mundësuan 61 njerëzve të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe aftësitë për kërkimin e punës.
- 50 persona përfunduan trajnimin profesional për shofer dhe 7 persona përfunduan trajnimin profesional për shofer për mjetet e transportit. Përafërsisht 75% e tyre arritën të pajisen me patentë shoferi ose të arrinin testin përfundimtar të ngjarjes në qytet, deri në fund të projektit.
- U krijua 1 faqe interneti, funksionale dhe operacionale dhe u krijua një qendër rajonale e pajisur për përkrahje profesionale dhe për qasje në tregun e punës, me qëllim, promovimin e rrugëve individuale për punësim, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve lokale në asistencën për kërkimin e punës dhe udhëzimeve për karrierë.
- 21 persona u punësuan:
 - 33 kompani u vizituan në Prilep, Manastir, Dollnen dhe Krivogashtan, u organizuan 3 biznes forume, u botua broshurës me rezultatet përfundimtare dhe u organizua një konferencë përmbyllëse.



1: Promovimi i mundësive për trajnimin e target grupeve; 2: Njerëzit e trajnuar në aftësi të buta / shkathtësi për punësim; 3: Sigurimi i mbështetjes individuale në proceset e kërkimit të punës (biznes forume); 4: Trajnim profesional për shoferët e mjeteve të transportit.

Outputet Kryesore / Rezultatet:

- Material promovues (flet palosje, postera, broshura).
- Materiale për edukim (Manual për gatishmëri për punë).
- 3 trajnime identike 7-ditore për aftësi për kërkimin e punës.
- Trajnime profesionale për shoferë dhe shoferë të mjeteve të transportit.
- Udhëzime individuale për karrierë për personat të pa favorizuar.
- 3 biznes forume.
- Një ngjarje fillestare.
- Një ngjarje për promovimin e rezultateve dhe metodologjisë për publikun e gjerë.

Treguesit Kryesorë:

- 60 persona të përzgjedhur do të kalojnë trajnimin profesional për lejen e vozitjes dhe shkathtësitë për aftësi të buta gjatë periudhës së zbatimit të projektit,
 - Arritje: 57 (95%) me sukses përfunduan trajnimin, 42 (70%) arritën testin final për vozitje në qytet dhe 7 (11.6%) arritën të pajisen me patentë shoferi deri në afatin e fundit të projektit (shumica e të tjerëve arritën të pajisen me të njëjtën, një muaj pas përfundimit të projektit).
- 30 persona u punësuan si rezultat i implementimit të projektit.
 - Arritje: 21(70%)
- U krijua 1 Qendër për Konsultim dhe Udhëzim për Karrierë për personat të pa favorizuar, funksionon dhe operon në kuadër të Qendrës për Punë dhe Politikë Sociale në Prilep.
 - Arritje: 1 (100%)
- U krijua një ueb faqe e specializuar e integruar me rrjetet sociale dhe faqe të tjera të dobishme për punë kërkuesit dhe njerëzit të pa favorizuar, është funksionale dhe operacionale.
 - Arritje: 1 (100%).

Qëndrueshmëria:

Në nivel të politikave, zbatimi i këtij projekti ka hapur derën për përmirësimin e strategjive komunale për zhvillim ekonomik me elemente për personat të pa favorizuar dhe praktikat pozitive për eliminimin e paragjyqimeve ndaj njerëzve të pa favorizuar..



Konferenca përmbyllëse në Prilep për prezantimin e rezultateve të projektit, për shpërndarjen e rezultateve të projektit dhe promovimin e modeleve të zhvilluara.

“Takime të këttilla për ne, kompanitë, janë të rëndësishme. Komunikimi i menjëhershëm dhe i relaksuar na jep mundësinë të shohim punëtorët tanë potencialë në një dritë tjetër, jep një mundësi që intervistat e rregullta nuk mund të sigurojnë. Ju inkurajoj, të vazhdoni të punoni në këtë drejtim dhe të përdorni metoda të ngjashme për të ndihmuar të rinjtë e zonave rurale të cilët për fat të keq kanë më pak mundësi për t’u ofruar në tregun e punës.”

(Pande Ilieska, SHPK BimFood Prilep)

“Trajnimi më dha shumë besim. Të hënën isha nervoz, ndjeja se isha i sëmurë dhe më vellej; por tani, kam ndjenjën se kam mësuar shumë.”

(Hristijan Ermanovski, pjesëmarrës në projekt)

“Unë jetoj në fshatin Krusheani.. Marrja e patentës për shofer, për mua do të thotë se nuk do të varem nga transporti publik që është shumë i rrallë dhe është mjaft i parregullt, dhe nëse do të punësohesha, do të udhëtoja rehatshëm deri në vendin tim të punës.”

(Marina Pridenkoska, pjesëmarrëse në projekt)

ORGANIZATA UDHËHEQËSE:

**QENDRA NDËR-KOMUNALE PËR PUNË SOCIALE – PRILEP
STEVAN APOSTOLOSKI 17, 7500 PRILEP
+389 48 421-702**

inter-municipal
Center for Social
Work - Prilep

DETAJET E KONTAKTIT TË PROJEKTIT:

**WWW.REI.MK/
WWW.FACEBOOK.COM/REIPRILEP**

ORGANIZATA PARTNERE:

**QENDRA KULTURORE RINORE – MANASTIR
CAR SAMUIL 29, 7000 MANASTIR
+389 47 233-020**

WWW.MKCBT@T.MK

WWW.FACEBOOK.COM/MKCBT/

@MKCBT

#MKCBITOLA

MKCBITOLA (INSTAGRAM)



KRIJIMI I RRUGËVE PËR PUNËSIMIN E TË RINJVE RURAL

Numri I identifikimit:
EuropeAid/135012/M/ACT/MK

Numri I kontratës.: 12-9139/1

Kohëzgjatja: 20 muaj

Periudha: 15.12.2015 – 14.08.2017

QËLLIMET SPECIFIKE:

1. Rritja e aftësive dhe të kuptuarit e punësimit tek të rinjtë rural.
2. Ndërtimi i sistemit rajonal për zhvillimin e fuqisë punëtore.
3. Zhvillimi i strategjisë rajonale për

Qëllimi i Përgjithshëm:

Lehtësimi i përfshirjes në tregun e punës të popullsisë së re nga zonat rurale dhe të largëta në rajonin e Maqedonisë Veri-Lindore.

Qëllimet Specifike:

*Rritja e aftësive dhe të kuptuarit e punësimit tek të rinjtë rural.
Ndërtimi i sistemit rajonal për zhvillimin e fuqisë punëtore.
Zhvillimi i strategjisë rajonale për përfshirjen sociale dhe në tregun e punës të target grupeve.*

Target Grupet / Përfituesit:

1. Të rinj të pa punësuar (mosha 20-39 vjeç), që jetojnë në rajonet rurale Veri – Lindore.
2. Qendra për Rajonin e Planifikuar Veri-Lindor;
3. Komunat: Kumanovë, Kratovë, Kriva Pallankë, Staro Nagoriçan, Likovë and Rankovc;
4. MBPEJ, MPPS, SHNA, GMLM;
5. sektori I shoqërive civile në rajonin Veri – Lindor

Lokacioni i Veprimit:

KOMUNAT: Kumanovë, Kratovë, Kriva Pallankë, Staro Nagoriçan, Likovë dhe Rankovc.



Vendosja praktike e të trajnuarve në 1: TV Medium Kriva Pallankë; 2: Job Club Likovë; dhe 3: Agjencia e sigurimeve Kumanovë.

Rezultate & Aktivitete Ne Zbatuara:

- **Përcaktimi i boshllëqeve ndërmjet nevojave në tregun e punës dhe aftësive ekzistuese të punës, dhe krijimi i mundësisë për "përputhjen e punës" midis punëdhënësve dhe të rinjve rural si punëtorë potencial:**
 - Studim kërkimor mbi tregun e punës në rajon,
 - Profilizimi i karakteristikave të target grupit.
- **Themelimi i sistemit për zhvillimin e aftësive personale, përmes klubeve të punës, si një pilot forme; zhvillim i trajnime të dedikuara për target grupet (120 individë); ofrimi i programit praktik për trajnim (45 individë) dhe sigurimi i punësimit të përkohshëm (36 individë):**
 - Themelimi i 3 klubeve të punës,
 - Implementim i projektit,
 - Mundësim i mësimin në sektorin e biznesit,
 - Ofrim i punësimit të përkohshëm në klubet e punës.
- **Themelimi i grupit mbështetës për fuqinë punëtore (GMFP) dhe zhvillim i strategjisë nacionale dhe plan veprim:**
 - Themelimi i grupit rajonal mbështetës për fuqinë punëtore ,
 - Analiza e shërbimit rajonal të kujdesit social, politikat nacionale dhe lokale dhe stimulimet relevante për nevojat e punësimit të target grupit,
 - Zhvillimi i strategjisë dhe planit të veprimit rajonal, për përfshirjen sociale dhe në tregun e punës të të rinjve nga mjediset rurale.
- **Rritja e vetëdijes midis target grupit dhe aktorëve të tjerë të aktiviteteve të Veprimit; dhe ndërgjegjësimi i publikut për nevojën për përfshirjen sociale të të rinjve nëpërmjet punësimit:**
 - Tre Panairt e Karrierës për përputhjen e vendeve të punës,
 - Promovim i vazhdueshëm.



1: Sektori i biznesit, pushteti lokal dhe pjesëmarrësit potencialë, Likovë; 2: Sesion trajnimi në komunikim efektiv, Shkup.

Outputet Kryesore / Rezultatet:

1. *Analiza e tregut të punës, Kërkesa e fuqisë punëtore në rajonin planor Veri-lindor (ISBN 978-608-4731-24-5; <http://cea.org.mk/analiza-na-pazarot-na-trud-pobaruvačka-na-rabotna-sila-vo-severoistochniot-planski-region>)*
2. *Analiza e tregut të punës, Të rinjtë e papunësuar në rajonin planor Veri – lindor (ISBN 978-608-4731-24-5; <http://cea.org.mk/istrzhuvane-na-pazarot-na-trud-mladite-nevraboteni-vo-severoistochniot-planski-region>)*
3. *Rishikimi i politikave për përfshirjen sociale të të rinjve, me fokus te të rinjtë në rajonin planor Veri – lindor (ISBN 978-608-4731-26-9; <http://cea.org.mk/analiza-i-pregled-na-politikite-za-sotsijalno-vkluchuvane-na-mladite>)*

Treguesit Kryesorë:

1. **Target: 120 të rinj të pa punësuar kanë përfunduar trajnimin. Arritja: 140 (116, 97%).**
2. **Target: 45 të rinj të pa punësuar përfunduan stazhin tre mujor në kompanitë. Arritja: 45, (100%).**
3. **Target: 36 të rinj të papunësuar fituan përvojë mësimore dy mujor në klubet e punës . Arritja: 48, (133%).**
4. **Target: 3 Klubet e hapura dhe funksionale të punës, personeli i trajnuar për shërbim. Arritja: 3, (100%).**
5. **Themelimi i 1 GMFP. Arritja: 1, (100%).**
6. **Zhvillimi i strategjisë dhe planit të veprimit, për përfshirjen sociale dhe në tregun e punës të të rinjve nga mjediset rurale. Arritja: 1, (100%).**

QËNDRUESHMËRIA:

1. Është përpiluar, paraqitur dokument strategjik rajonal i cili mund të përdoret nga palë të ndryshme të interesit.
2. Pajimi dhe transferimi i pajisjeve për operim të mëtejshëm në tri nga gjashtë komuna.
3. Veprime të vazhdueshme për përmirësimin e papunësisë së target grupeve të ndryshme.



Planifikim i përbashkët i palëve të interesuara për përmirësimin e punësimin rajonal.

“Dua të theksoj se do të mbroj fuqishëm praktikën e cila do të kryhet në Klubin e punës, dhe se në kuadër të Komunës nuk do të paraqesë vetëm formalitet, por do të përdoret nga të rinjtë e pa punësuar në mënyrë maksimale, për të cilët përvoja dhe aftësitë praktike janë jashtëzakonisht të rëndësishme.”

(Milovan Stojkovski, Kryetar i Komunës Staro Nagoriçane)

“Komuna e Likovës ballafaqohet me shkallën e papunësisë prej rreth 80%, kështu që aktivitetet e ndërmarra nga CEA dhe FFRM janë shumë të rëndësishme për të rinjtë Projekti ofron mundësi që të rinjtë të arsimohen më tutje, të integrohen dhe të vizitojnë trajnime praktike në mënyrë që të kenë mundësi të përmirësuar për punësim dhe të rrisin nivelin e standardit aktualisht të ulët të jetesës në komunën e tyre.”

(Dije Arifi, Koordinatore e ZhEL, Komuna e Likovës, përfitues lokal i aktiviteteve të projektit)

“Dua të theksoj se ndihem i privilegjuar që kam qenë pjesë e klubit të punës në komunën e Likovës. Projekti mundësoi mentorimin e 6 grupeve të praktikantëve në komunë dhe mbi 15 praktikantë në lidhje me bizneset përkatëse ... pjesëmarrësit ishin aktivë gjatë gjithë kohës dhe u pasuruan vazhdimisht me njohuri të reja”

(Muhedin Abazi, trajnues lokal në Klubin e punës, integruar, pjesë e projektit, në bashkëpunim me NJVL-në, Likovë)

ORGANIZATA UDHËHEQËSE:

Qendra për analiza ekonomike (CEA) – Shkup



Jane Sandanski 63/3, 1000 Shkup,


+389 2 244-4766

www.cea.org.mk

www.mkbudget.org/

www.facebook.com/ceaorgmk/

ORGANIZATA PARTNERE:



Federata e Farmerëve të Maqedonisë – Shkup

Gigo Mihalovski, 4-1/1, 1000 Shkup

+389 2 305-0646

www.ffrm.org.mk

DETAJET E KONTAKTIT TË PROJEKTIT:

[WWW.FACEBOOK.COM/SOZDAVANJEMOZNOSTI/](https://www.facebook.com/sozdavanjemoznosti/)

[WWW.FFRM.ORG.MK](http://www.ffrm.org.mk)



PËRFSHIRJA NË TREGUN E PUNËS TË TË RINJVE TË PA FAVORIZUAR SOCIAL NË RAJONIN VERI - LINDOR

Numri i identifikimit: *EuropeAid/135012/M/ACT/MK*

Fusha e politikave: *Përfshirja sociale*

Numri i kontratës: *12-9142/1*

Nën fusha e politikës: *Nxitja e përfshirjes sociale të personave të pa favorizuar në tregun e punës*

Kohëzgjatja: *15 muaj*

Buxheti: *143,965.29 EUR*

Periudha: *14.12.2015 – 14.03.2017*

Kontributi i BE-së: *133,887.72 EUR*

Qëllimi i Përgjithshëm:

Të ndihmojë përfshirjen e të rinjve në tregun e punës nga rreziku i përjashtimit social nga Rajoni Veri-lindor i vendit.



Qëllimet Specifike:

- 1. Tu ofrojë të rinjve (të moshës 18-30 vjeç) që janë të rrezikuar nga përjashtimi social, aftësi të certifikuara profesionale.*
- 2. Tu ofrojë të rinjve (të moshës 18-30 vjeç) që janë të rrezikuar nga përjashtimi social, shkathtësi punësimi.*
- 3. Tu ndihmojë njerëzve të rinj (të moshës 18-30 vjeç) që janë të rrezikuar nga përjashtimi social, nëpërmjet orientimit në karrierë dhe fuqizimit psiko-social.*
- 4. Tu ndihmojë njerëzve të rinj (të moshës 18-30 vjeç) që janë të rrezikuar nga përjashtimi social,*

Target Grupet / Përfituesit:

Personat e rinj në rrezik të përjashtimit social që jetojnë në rajonin Veri-lindor të vendit, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara gjendja e të cilëve ia bën ata të përshtatshëm për punë, siç janë: ish-vartës të drogës dhe alkoolit, viktima të dhunës familjare, të rinjtë që kanë kryer kundërvajtje, të rinj që herrët janë larguar nga shkollimi, të rinj me nevoja të veçanta (paftësi të lehta fizike apo mendore) dhe të rinj pa kujdes prindëror.

Lokacioni i Veprimit:

Komuna e: Kumanovës, Kriva Pallankës, Likovës, Kratovës, Rankovc, Staro Nagoriçan.



1: Trajnimi për shkathtësitë e punësimit; 2: Këshillim psiko-social; 3: Trajnimi për shkathtësitë profesionale.



Rezultate & Aktivitete të Zbatuara:

- 1. Tu ofrojë të rinjve (të moshës 18-30 vjeç) që janë të rrezikuar nga përjashtimi social, aftësi të certifikuara profesionale:**
 - 60 pjesëmarrës të përfshirë në trajnimin profesional,
 - 2 grupe në gjuhën maqedonase (17 pjesëmarrës) për instalues dhe montues në ndërtesat e banimit,
 - 3 grupe për operimin e makinave me kontrollim numerik: 2 grupe në gjuhën maqedonase (19 pjesëmarrës) dhe 1 grup në gjuhën shqipe (24 pjesëmarrës).
- 2. Tu ofrojë të rinjve (të moshës 18-30 vjeç) që janë të rrezikuar nga përjashtimi social, shkathtësi punësimi:**
 - 60 pjesëmarrës kanë trajnim 12-ditor për shkathtësi punësimi - vlerësimet dhe raportet tregojnë aftësi të përmirësuar të punësimit. Raportet e aktivitetit, raportet e trajnimit, raportet e frekuentimit, anketat e kënaqësisë së pjesëmarrësve, të gjitha realizuar dhe janë në dispozicion sipas kërkesës.
- 3. Tu ndihmojë njerëzve të rinj (të moshës 18-30 vjeç) që janë të rrezikuar nga përjashtimi social, nëpërmjet orientimit në karrierë dhe fuqizimit psiko-social:**
 - 60 pjesëmarrësit kanë 8 ditë këshillim për karrierë dhe 8 ditë këshillim psiko-social.
- 4. Tu ndihmojë njerëzve të rinj (të moshës 18-30 vjeç) që janë të rrezikuar nga përjashtimi social:**
 - 7 kompani nënshkruan kontratat e praktikës me projektin,
 - 59 praktikues,
 - 20 ditë punë praktike për pjesëmarrësit,
 - Pas përfundimit të punës praktike, 2 pjesëmarrës nënshkruan kontrata pune.



1 & 2: Trajnimi për aftësi profesionale; 3 & 4: Puna praktike.

Outputet Kryesore / Rezultatet:

- Ofrimi i mësimave për aftësi profesionale.
- Ofrimi i kurseve për punësim.
- Ofrimi i konsultimeve për karrierë dhe konsultimeve psiko – sociale.
- Organizimi dhe zbatimi i praktikës.

Treguesit Kryesorë:

- 1. Numri i personave të rinj (18 -30 vjeç) në rrezik nga përjashtimi social të trajnuar me aftësi profesionale.**
 - Targeti 60 . Arritja: 60 (100%)
- 2. Numri i personave të rinj (18-30) në rrezik nga përjashtimi social me aftësi të përmirësuar për punësim**
 - Targeti 60. Arritja: 60 (100%)
- 3. Numri i personave të rinj (18-30) në rrezik nga përjashtimi social të cilët u ndihmuan të krijojnë qëllime dhe u forcuan psiko-socialisht**
 - Targeti 60. Arritja: 60 (100%)
- 4. Numri i personave të rinj (18-30) në rrezik nga përjashtimi social të cilët bënë praktikë në kohëzgjatje prej një muaj.**
Targeti 60: Arritja: 59 (98.3%).



Qëndrueshmëria:

1. **Inventari i blerë (makina CNC dhe mjete për inxhinierët elektrikë) do të përdoren në zbatimin e udhëzimeve praktike për studentët e rregullt. Shkolla ka marrë akreditim nga Qendra për Arsimin e të Rriturve për të kryer trajnimin për montues dhe instaluesit në ndërtesat e banimit dhe trajnimin për të punuar me makinën CNC. Në të ardhmen, shkolla do të aplikojë për zbatimin e këtij lloji të trajnimit për të rinjtë.**
2. **Nxënësit që përdorin makinat CNC filluan me prodhimin e suvenireve.**
3. **Gjatë kontaktit me pjesëmarrësit, pas 2 muaj, morëm informata se më shumë se 15 prej tyre gjetën punë si rezultat i trajnimeve dhe forcimit të kapaciteteve të tyre.**



Project beneficiaries taking an apprenticeship.

“Ishim këndshëm të befasuar me interesin e madh të treguar nga pjesëmarrësit dhe pjesëmarrjen e tyre të rregullt. Jemi mirënjohës për këtë projekt, duke na dhënë mundësinë për t’u takuar personalisht me njerëz që potencialisht mund të bëhen punonjësit tanë dhe për t’i trajnuar ata në procesin e prodhimit specifik për nevojat tona dhe kërkesat teknike.

Dhe me të vërtetë, në fund të programit të stërvitjes, ne kemi punësuar dy nga nxënësit të cilët sipas vlerësimit tonë kanë treguar përkushtim të vendosur dhe një dëshirë të ndershme për të qëndruar në kompaninë tonë. Ne u dhamë atyre punë!”

(aktor i projektit, Menaxheri i Cilësisë në kompaninë e prodhimit të mobiljeve "Mahagoni")

“Ky projekt më ofroi trajnim që më ndihmoi të fitoj njohuri dhe shkathtësi dhe vetëbesim personal, si të prezantohem tek punëdhënësit dhe në tregun e punës. Fitova aftësitë për montues dhe instalues në ndërtesat e banimit dhe e di se tani mund të gjej punë.”

(Bajram Abdulovski përfitues i projektit)

“Me trajnimet që kam marrë në projektin e Shkollës së AFP-së 'Nace Bugjoni' dhe mësimi i profesionit më ndihmuan të punësohem nga kompania 'Mahagoni' në postin e operatorit me makina CNC.”

(Branislav Veliçkovski, përfitues i rojektit)

ORGANIZATA UDHËHEQËSE:

SHKOLLA E MESME TEKNIKE KOMUNALE 'NACE BUGJONI' – KUMANOVË



Bajram Shabani pn, 1300 Kumanovë
+389 31 432-180
www.nacebugjoni.mk

ORGANIZATA PARTNERE

Qendra për Zhvillimin e Rajonit Planor Veri-Lindor–Kumanovë



Ilindenska pn, 1300 Kumanovë, Maqedoni
+389 31 424-878
www.northeastregion.gov.mk

DETAJET E KONTAKTIT TË PROJEKTIT:

WWW.FACEBOOK.COM/NACEBUDJONIPROJECT/



PREJ NDËRTIMIT TË EIQ DERI TE TREGU I PUNËS GJITHËPËRFSHIRËS

Numri i identifikimit: *EuropeAid/135012/M/ACT/MK* Fusha e politikave: *Përfshirja sociale*

Numri i kontratës: *12-9130/1*

Nën fusha e politikës: *Nxitja e përfshirjes sociale të personave të pa favorizuar në tregun e punës*

Kohëzgjatja: *18 muaj*

Buxheti: *110,354.08 EUR*

Periudha: *14.12.2015 – 14.06.2017*

Kontributi i BE-së: *93,800.96 EUR*

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM:

1. Të bëjë përmirësime në trajnimet që ofrohen aktualisht duke marrë një qasje pjesëmarrëse në përpilimin e shërbimeve të trajnimit. Për këtë qëllim, 50 trajnime një ditore, të përshtatura në mënyrë të posaçme janë ofruar për target grupet.
2. Rritja e përfshirjes së target grupit në tregun e punës përmes një procesi të këshillimit të përditshëm nga ekspertë të punësimit.
3. Zhvillimi i kapaciteteve të firmave ku kryhet trajnimi praktik i pjesëmarrësve për kalimin e menjëhershëm në tregun e punës.
4. Rritja e vetëdijes publike për përfitimin nga vullnetarizmi.

Qëllimet Specifike:

1. Të mbështesë personat në nevojë në procesin e punësimit duke ofruar trajnime të specializuara dhe mentorim individual.
2. Të inkurajojë politikat rajonale të punësimit, duke nxitur bashkëpunim të ngushtë ndër-komunal.
3. Të përmirësojë përvojën praktike të target grupit duke transferuar qasjen inovative të praktikave më të mira, të përshtatura sipas nevojave specifike të target grupeve.
4. Të promovohet vullnetarizmi si një rrugë alternative për trajtimin e papunësisë me ngritjen e vetëdijes publike.

TARGET GRUPET / PËRFITUESIT:

1. Persona që jetojnë në zonat e largëta dhe rurale,
2. Të rinjtë e papunë (20-29 vjeç),
3. persona që nuk e kanë mbaruar arsimin e mesëm
4. pakicat etnike (turqit dhe serbët).

LOKACIONI I VEPRIMIT:

Komuna e Demir Kapisë dhe Komuna e Rosomanit.



1 & 2: Trajnim i specializuar për "Rritjen e aftësive motivuese për ri-hyrje në tregun e punës";
3: Dita ndërkombëtare e vullnetarizmit.

REZULTATE & AKTIVITETE TË ZBATUARA:

- 1. **Përmirësimet në trajnimet që ofrohen aktualisht me qasje pjesëmarrëse në përpilimin e shërbimeve të trajnimit:**
 - Aktivitetet përgatitore,
 - Përgatitja e studimit,
 - Shërbime trajnimi të specializuara ShTS.
- 2. **Përfshirje më e madhe e target grupeve në tregun e punës nëpërmjet procesit të mentorimit ditor nga ekspertët e punësimit:**
 - Mentorim individual dhe grupor.
- 3. **Zhvillimi i kapaciteteve të firmave ku kryhet trajnimi praktik i pjesëmarrësve për kalimin e menjëhershëm në tregun e punës:**
 - Firma ku zhvillohet praktika.
- 4. **Rritja e vetëdijes publike për përfitimin nga vullnetarizmi:**
 - Promovim i vullnetarizmit



Trajnime të specializuara të zhvilluara në Komunën e Demir Kapisë dhe në Komunën e Rosomanit.

OUTPUTET KRYESORE / REZULTATET:

Publikim i një studimi: “Mundësitë e Tregut të Punës– Studim special për Rajonin Planor të Vardarit ” (ISBN 978-9989-2704-751).

TREGUESIT KRYESORË:

1. **Numri i trajnimeve të specializuara.**
 - **Vlera e synuar: 50 trajnime. Vlera e arritur: 50 (100%).**
2. **Numri i ditëve të kryerjes së mentorimit individual ose grupor.**
 - **Vlera e synuar: gjithsej 50 ditë. Vlera e arritur: U kryen 100 ditë (200%).**
3. **Numri i trajnimeve praktike të organizuara në firma.**
 - **Vlera e synuar: të paktën 6 firma për punë praktike. Vlera e arritur: u organizua praktikë në 6 firma (100%).**
4. **Numri i broshurave tremujore të shpërndara.**
 - **Vlera e synuar: 1200 kopje në të dy komunat. Vlera e arritur: u botuan 1200 broshura (100%).**
5. **Numri i sesioneve informative.**
 - **Vlera e synuar: gjithsej 6 në të dy komunat. Vlera e arritur: u organizuan 6 sesione informative mbi vullnetarizmin (100%).**
6. **Numri i pjesëmarrësve në DBV.**
 - **Vlera e synuar: 100 pjesëmarrësit e pranishëm në të dy komunat (prej 30 deri në 50 person në secilën komunë). Vlera e arritur: 70 pjesëmarrës të pranishëm gjatë DBV në të dy komunat (70%).**

QËNDRUESHMËRIA:

1. Në fund të projektit, certifikata për pjesëmarrje u janë dhënë të gjithë pjesëmarrësve që përfunduan të dy pjesët e trajnimeve të specializuara.
2. Në fund projektit, certifikata për pjesëmarrje për të fituar shkathtësi të caktuara u janë dhënë të gjithë pjesëmarrësve që morën pjesë aktive në firmat ku u zhvillua praktikë tre ditore.

“Gjatë dhe pas implementimit të projektit kemi arritur një ndikim të madh tek anëtarët e target grupit. Shërbimet e trajnimit të specializuara, të përshtatura kanë ndikuar shumë, te anëtarët e target grupit në ndërtimin e shkathtësive të tyre në fusha të ndryshme, por ndikimi më i madh ishte në ndërtimin e besimit dhe motivimin e tyre për ri-hyrje në tregun e punës.”

(Blagoj Jovanovski,
Nëpunës financiar i projektit)



Takim me partnerët e Komunës së Rosomanit.

“Kam marrë pjesë në disa nga shërbimet e specializuara të trajnimit, por trajnimi që bëri ndryshime në jetën time ishte trajnimi për Fondet IPARD. Isha i ri dhe i papunë. Pasi morra pjesë në trajnimin për fondet IPARD, mësova më shumë për përfitimet nga fondet IPARD, për dikë që dëshiron të provojë dhe të zbatojë masat e vetë punësim. Granti im u miratua dhe tani, drejtoj biznesin tim të vogël.”

(M.P., Përfitues i Projektit)

ORGANIZATA UDHËHEQËSE:

Komuna e Demir Kapisë

11 Oktomvri pn. 1442 Demir Kapi

+389 43 364-100

www.opstinademirkapija.gov.mk



ПАРТНЕРСКИ ОРГАНИЗАЦИИ:

Komuna e Rosomanit

Proleterska 1, 1422 Rosoman

+389 43 441-443

www.opstinarosoman.gov.mk



Fondacioni New Business Education



Kosta Novakoviq 8, 1000 Shkup, Maqedoni

+389 2 240-2161

nbe.mk

DETAJET E KONTAKTIT TË PROJEKTIT:

www.podobruvanjenamoznostite.eu

[www.facebook.com/](https://www.facebook.com/FromEiqBuildUptoanInclusiveLabourMarket/)

[FromEiqBuildUptoanInclusiveLabourMarket/](https://www.facebook.com/FromEiqBuildUptoanInclusiveLabourMarket/)

ARSIMI DHE TRAJNIMI PROFESIONAL- QASJE E RE PËR PËRFSHIRJE EFEKTIVE SOCIALE

Numri identifikues : *EuropeAid/135012/M/ACT/MK*

Nr. i kontratës : *12-9131/1*

Kohëzgjatja: *18 muaj*

Periudha: *14.12.2015 – 14.04.2017*

Fusha e politikave: *Përfshirja sociale*

Nën fusha e politikave: *Nxitja e përfshirjes sociale të personave të pafavorizuar në tregun e punës*

Buxheti: *101,652.14 EUR*

Kontributi i BE-së: *96,569.53 EUR*

Qëllimi i Përgjithshëm:

- Të kontribuojë në krijimin e një mjedisi të favorshëm për ri integrimin e shkelësve të ligjit në shoqëri.*
- Nëpërmjet aktiviteteve të mbikëqyrura ne do t'u ofrojmë mundësi të burgosurve të mësojnë aftësi të reja dhe të jenë konkurrues në tregun e punës pas vuajtjes së dënimit.*

Target Grupet / Përfituesit:

- Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve;*
- Burgu i Tetovës, burgu i Shtipit.*
- Avokati i Popullit.*
- Agjencia për Punësim.*
- Dhomat e Tregtisë dhe Punëdhënësit. Qendrat për Punë Sociale; Qendra për Edukimin e të Rriturve*
- Komuna e Tetovës, Komuna e Shtipit.*

Qëllimet Specifike:

- Burgjet në Tetovë dhe Shtip duhet të rrisin kapacitetet e tyre për të ofruar trajnime për aftësitë profesionale të orientuara për tregun e punës.*
- Numri i personave shkelës të ligjit që kthehen përsëri në burg, duhet të ulet.*
- Të burgosurit do të kenë mundësi të rrisin njohuritë / arsimimin dhe aftësitë e tyre profesionale.*
- Aktivitetet edukative duhet të pranohen si aktivitete të rregullta në burgjet.*

Lokacioni i Veprimit:

Tetovë, Shtip.



Konferenca përfundimtare, BE Info Qendra Shkup 06.04.2017.

Rezultate & Aktivitete të Zbatuara:

- Kushtet e ofruara për realizimin e trajnimeve të përditshme edukuese në burgun e Tetovës dhe Shtipit (pajisjet, programet dhe mjetet):**
 - Pajimi i 2 klasave me pajisje teknike të nevojshme për zhvillimin e llojeve të ndryshme të lëndëve (Kompjuter, IKT pajisje, karrige, tabletë etj.) dhe 2 klasa me pajisje teknike të nevojshme për zhvillimin e trajnimeve profesionale),
 - Procesi i hartimit të programeve të veçanta arsimore të përshtatura posaçërisht për nevojat e të burgosurve (shkrim-leximit bazik, gjuhë të huaja, aftësitë kompjuterike, etj.).
- Në afat të gjatë, të burgosurit përfitojnë nga rritja e kapaciteteve dhe janë më konkurrues në tregun e punës pas vuajtjes së dënimit:**
"Falë projektit, pjesëmarrësit janë më të sigurt dhe janë gjithashtu në gjendje të punojnë me kompjuterë dhe të kenë aftësi të përmirësuara të shkrim-leximit. Këto janë të nevojshme për punë në supermarketin tonë.

5 nga pjesëmarrësit përfunduan 2 javë trajnime në tregjet tona të vendosura në zonat ku jetojnë romët. Plani im është të punësojë të paktën 2 prej tyre. "

(Fatmir Arifi, pronar i SupermarketitGrapromSHPKSHV)

ORGANIZATAT UDHËHEQËSE:

Internationaler Bund e.V., IB Süd – Stuttgart



Heusteigstraße 90/92, 70180 Stuttgart, Germany

+49711 645-4401

<https://www.internationaler-bund.de>

DETAJET E KONTAKTIT TË PROJEKTIT:

<http://fit-for-the-future.org.mk/>

<https://www.facebook.com/Fit-for-the-Future-263982184042774/?fref=ts>

ORGANIZATAT PARTNERE:

IrhomTopaana – Shkup

Civil Society IRHOM- TOPAANA
Street: Blagoja Parovic 13-2/9 Skopje



BlagojaParovik 13-2/9,1000 Skopje,

+38971 262-221

<https://www.facebook.com/Association-of-citizens-Irhom-Topaana-267534847042>

QASJA E ROMËVE NË (VETË) PUNËSIM

Numri identifikues i thirrjes: *EuropeAid/136315/ID/ACT/MK*

Fusha e politikave: *Përfshirja sociale*

Numri i kontratës: *12-8404/1*

Nën fusha e politikave: *Përfshirja e Romëve në tregun e punës*

Kohëzgjatja: *12 muaj*

Buxheti: *151,580.85 EUR*

Periudha: *27.12.2016 – 27.12.2017*


Kontributi i BE-së: *144,001.81 EUR*

Qëllimi i Përgjithshëm:

Kontributi në përfshirjen e Komunitetit Rom në tregun e punës.

Qëllimet Specifike:

Rritja e shkathësisë të grave rome dhe anëtarëve të komunitetit egjiptian të vetë deklaruar për vetë (punësim).



Target Grupet / Përfituesit:

1. Popullsia rome dhe egjiptianët e vetë deklaruar (për Rajonin Jugperëndimor), si gratë dhe burrat; 2. Deri në 25% të target grupit mund të vijnë nga anëtarët e grupeve të tjera etnike, duke ndarë të njëjtin interes dhe synime për (vetë) punësim dhe përfshirje sociale.

Lokacioni i veprimit:

Rajoni i Shkupi dhe Rajon i Jugperëndimor.



Trajnime për rritjen e potencialeve për gjetjen e punës dhe gjetjen e aftësive për vetëpunësim.

Rezultatet dhe Aktivitetet e Zbatuara:

- Rritja e potencialeve për gjetjen e punësimit të romëve:**
 - Identifikimi dhe përzgjedhja e romëve të papunë për rritjen e shkathtësive të punësimit,
 - Dispozita e trajnimit / praktikës në vendin e punës,
 - Trajnim për gjetjen e punës dhe aftësive komunikuese.
- Rritja e aftësive të vetëpunësimit për sipërmarrësit potencial romë:**
 - Identifikimi i fillestarëve dhe sipërmarrësve,
 - Trajnim për aftësitë sipërmarrëse.
- Janë zhvilluar aftësitë profesionale midis komunitetit rom dhe egjiptianëve të vetë-deklaruar:**
 - Identifikimi i ofruesve të mundshëm të trajnimit profesional,
 - Trajnim për aftësitë e profesionit.
- Janë adresuar faktorët motivues për regjistrimin e bizneseve fillestare:**
 - Janë kryer intervista me fillestarët dhe sipërmarrësit,
 - Analiza mbi pengesat për fillimin e regjistrimit të biznesit dhe vetë (punësimi),
 - Prezantimi i rezultateve të projektit dhe analizës.



Anëtarët e target grupit që marrin pjesë në trajnime për gjetjen e aftësive të punësimit dhe të komunikimit, aftësitë e sipërmarrjes dhe trajnimin në vendin e punës.

Outputet Kryesore / Rezultatet:

- Trajnimi në vendin e punës / praktika (identifikimi i organizatave të romëve dhe egjiptianëve të vetëdeklaruar, zhvillimi i pyetësorit dhe profileve, shpërndarja trajnimit për punësim dhe komunikim, si dhe praktikën në vendin e punës).
- Pronarët e bizneseve të themeluara dhe fillestarët romë të profilizuar dhe të trajnuar; janë zhvilluar planet e biznesit.
- Trajnime profesionale të ofruara për anëtarët e targetgrurit.
- Intervistat, një sondazh dhe një analizë lidhur me pengesat e (vetë)punësimit për romët dhe egjiptianët e vetëdeklaruar.
- E organizuar ngjarja përfundimtare.

Treguesit Kryesor:

- Zhvillohet pyetësori i identifikimit. • Targeti: 1. Arritja: 100%.
- Identifikimi i organizatave të njohura rome dhe organizatave të egjiptianëve të vetëdeklaruar. • Targeti: 2. Arritja: 100%.
- Zhvillimi i pyetësorëve dhe profileve. • Targeti: 90. Arritja: 100%.
- Fillimi i thirrjeve për ofrimin e trajnimeve / praktikës në vendin e punës. • Targeti: 2. Arritja: 100%.
- Trajnim 2-mujor në vendin e punës / praktikë për romët e papunë. • Targeti: 20. Arritja: 190% (38).
- 4 ditë trajnimi për gjetjen e aftësive për punësim dhe komunikim. • Targeti: 30. Arritja: 143% (70).
- Identifikimi i 30 pronarëve të biznesit të themeluar dhe fillestarëve romë, krijimi i profileve të shkurtra profesionale. • Targeti: 30. Arritja: 100%.
- Trajnimi i pronarëve të bizneseve dhe bizneset e reja rome. • Targeti: 30. Arritja: 227% (68).
- Organizimi i trajnimeve për aftësitë sipërmarrëse. • Targeti: 2. Arritja: 100%.
- Në vazhdimësi: do të organizohet një prezantim i planeve të biznesit dhe do të jepen 3 shpërblime për planet më të mira të biznesit.
- Identifikimi i ofruesve të trajnimit profesional. • Targeti: 2. Arritja: 250% (5).
- Trajnimi 3 mujor i aftësive profesionale në anëtarët e target grupit. • Targeti: 10. Arritja: 170% (17).
- Në vazhdimësi: 17 anëtarë të targetgrurit do të marrin certifikatë për përfundimin me sukses të trajnimit profesional të nivelit bazë.
- Në vazhdimësi: do të zhvillohen 20 intervista me pronarët e bizneseve të vogla, target grupet dhe sipërmarrësit, pronarët e mikro bizneseve, bizneset e paregjistruara në mënyrë specifike nga target grupi.
- Në vazhdimësi: do të bëhet një studim mbi një mostër përfaqësuese për analizimin e pengesave (vetë) të punësimit të popullsisë rome në vend dhe popullsisë së vetë deklaruar egjiptiane.
- Në vazhdimësi: 1 analiza do të printohet dhe do të shpërndahet target grupeve të organizatave civile, institucioneve publike, organeve shtetërore përkatëse që punojnë në politikën e tregut të punës, përfshirjen sociale dhe arsimin.
- Në vazhdimësi: do të organizohet një ngjarje përfundimtare ku do të paraqiten rezultatet e projektit dhe gjetjet.
- e do të vazhdojë në të ardhmen t'i zbatojë veprimet për përfshirjen sociale.
- LDA Struga në Rajonin Jugperëndimor është vazhdimisht e përfshirë në zbatimin e projekteve të përfshirjes sociale.
- Metodologjia e përdorur (mentorimi dhe trajnimet profesionale) do të përdoren në projektet e mëtejshme të zbatimit.
- Metodologjia e përdorur në projekt është e hapur dhe do të përsëritet në projekte të tjera që synojnë rritjen e shkathtësive të punësimit.

Qëndrueshmëria:

1. MEDF ka zbatuar dhe do të vazhdojë të zbatojë projektet e ardhshme për përfshirje sociale. 2. LDA Struga në Rajonin Jugperëndimor vazhdimisht përfshihet në zbatimin e projekteve të inkluzionit social. 3. Metodologjia e përdorur (mentorim dhe trajnime profesionale) do të përdoren për zbatimin e mëtutjeshëm të projekteve. 4. Metodologjia e përdorur në projektin është e gatshme për opinionin e gjerë dhe mund të kopjohet në komunitete tjera dhe rajone.

"Ky është një nga programet më të dobishme në të cilën Shtëpia e Kursimeve 'Možnosti' dhe MEDF punuan së bashku. Të dy pjesëmarrësit me se sigurt treguan angazhim të madh, dheishin në ndihmë të madhe për punonjësit tanë gjatë trajnimit në vendin e punës".

(Suzana Kostova, Drejtore e Burimeve Njerëzore në Shtëpinë e Kursimeve 'Možnosti', Shkup,

ofruesi i trajnimit 2-mujor në vendin e punës / praktikë për 2 pjesëmarrës të projektit)



"Përvoja ime me këtë trajnim në vendin e punës ka qenë deri tani një nga përvojat më interesante profesionale që kam hasur. Më mëson diçka të re çdo ditë dhe ka më shumë për të mësuar, jam i sigurt. "

(Alen Umer, pjesëmarrës në trajnimin 2-mujor në vendin e punës në Shtëpinë e Kursimeve "Možnosti", Shkup)

Dhënia e certifikatave për përfundimin e suksesshëm të trajnimit në gjetjen e aftësive të punësimit dhe komunikimit në Rajonin e Shkupit

ORGANIZATAT UDHËHEQËSE:

Fondacioni MaqedonaspërZhvillimin–Shkup

Nikola Parapunov 41A, 1060 Skopje,
+389 2 308-8988

www.mrfp.mk

<https://www.facebook.com/mrfp.mk/>

ORGANIZATAT PARTNERE:

Agjencia përZhvillimin e ShoqataveLokale–Strugë

Dimce Kovačeski 30/2, 6330 Struga,
+389 46 784 151

www.ldastruga.org

DETAJET E KONTAKTIT TË PROJEKTIT:

www.mrfp.mk;

<https://www.facebook.com/mrfp.mk/>

ZHVILLIMI I NJË MODELI TË QËNDRUESHËM PËR PUNËSIMIN E ROMËVE

Numri identifikues i thirrjes: *EuropeAid/136315/ID/ACT/MK*

Fusha e politikave: *Përfshirja sociale*

Numri i kontratës: *12-8407/1*

Nën-fusha e politikave: *Përfshirja e Romëve në tregun e punës*

Kohëzgjatja: *12 muaj*

Buxheti: *181,282.50 EUR*

Periudha: *01.01.2017– 31.12.2017*

Kontributet e BE-së: *168,592.73 EUR*

Qëllimi i Përgjithshëm:

Të kontribuojë në integrimin e qëndrueshëm të romëve në tregun e punës, duke përmirësuar punësimin e tyre në sektorin e ndërtimit të banesave dhe sektorin e efikasitetit të energjisë.

Qëllimet Specifike:

- 1. Të rriten potencialet e punësimit të romëve që sigurojnë kapacitete personale të përshtatshme dhe të vlefshme në treg.*
- 2. Të lehtësojë qasjen në tregun e punës me fokus në sektorin e ndërtimit.*

Target Grupet / Përfituesit:

Burra dhe gra romë të përfshira në projekte dhe grupe të tjera të marginalizuara që do të përfitojnë nga modeli i zhvilluar i punësimit.

Lokacioni i veprimit:

Kumanovë dhe Prilep.



Meshkujt romë fitojnë aftësi praktike në ndërtimin e mureve me gips karton në Prilep.

Rezultatet dhe Aktivitetet e Zbatuara:

- Kompetencat në aftësitë ndërtimore dhe metodat e zhvilluara në target grupet:**
 - Vlerësimi i nevojave për trajnim u krye në mesin e punëtorëve romë të parazgjedhur,
 - Trajnime teorike në punimet e fasadave dhe në ndërtimin e mureve me gips kartonë, muratori dhe instalimet e dyerve dhe dritareve,
 - Trajnim praktik në punimet e fasadave dhe në ndërtimin e mureve me gips karton, në muratori dhe instalimet e dyerve dhe dritareve.
- Rrjeti i punësimit në ndërtimtarika themeluar:**
 - Hartimin e kompanive lokale të ndërtimit dhe palëve të interesuara,
 - Punëtori për mësim ndërkulturor,
- Data baza e punëtorëve të certifikuar dhe zhvillimi i kompanive të ndërtimit.**
 - Vetëbesim për gjetjen e punës:
 - Trajnimi për punësim,
 - Panairt e punës për sektorin e ndërtimit,
 - Përputhja e punonjësve dhe punëdhënësve potencial.



Njerëzit romë fitojnë aftësi praktike për masonerinë Prilep.

Outputet Kryesore / Rezultatet:

- 67 burra romë të trajnuar në punimet e fasadave dhe në ndërtimin e mureve prej gips kartoni, muratori, instalime të dyerve dhe dritareve.**
- 43 punëtorë ndërtimtarie të certifikuar.**
- 74 meshkuj dhe 48 gra kishin forcuar aftësitë e tyre të kërkimit të punës.**
- 20 kompani lokale të ndërtimit të angazhuara në Veprim nëpërmjet takimeve dhe punëtorive lokale.**
- Zhvillohet baza e të dhënave të punëtorëve të certifikuar të ndërtimit dhe të kompanive lokale të ndërtimit.**

Treguesit Kryesor:

- Numri i romëve që përfunduan trajnimin dhe programin e ndërtimit të kapaciteteve.**
o Target: 120. Arritjet deri më tani: 110 (92%).
- Numri i grave dhe burrave romë që përfunduan trajnimin në punësueshmëri**
o Target: 120. Arritjet deri më tani: 74 (62%).
o Target: 120. Arritjet deri më tani: 48 (240%)
- Rrjeti ndërtimor funksional dhe i mbushur me personel.(në zhvillim)**
- Indikatori: data-bazës e dhe regjistri i të hyrave..(në zhvillim)**

Qëndrueshmëria:

1. **Trajnime në aftësitë e punësimit.**
2. **Certifikimi i 43 punëtorëve ndërtimor në Kumanovë dhe Prilep.**
3. **Databaza e punëtorëve të ndërtimtarisë të certifikuar dhe të kompanive lokale të ndërtimit.**

"Romët me trajnim të përshtatshëm mund të mësojnë të bëhen punëtorë të dalluar dhe të besueshëm. Ky projekt do t'i ndihmojë punëtorëve romë në lidhjen me kompanitë lokale të ndërtimit në Prilep dhe do të krijojë bazën e punëtorëve që do të kërkojnë punësim brenda sektorit. "

(Goce Stojanovski, pronar i Rabusplast, Rrjeti përpunësimin e romëve në ndërtimtar)



Rom që punon në instalimin e dritareve në Kumanovë.

"Unë jam Aliu dhe në këtë projekt jo vetëm se kam mësuar se si të bëj fasadë dhe ndërtimin e murit me gips kartonë, por edhe si të jem profesional kur kërkoj punë. Në të ardhmen, dua të bëhem krye shef dhe të hap biznesin tim të ndërtimit ".

(AliAjdarovski, përfituesi përfundimtar)

YOU!

ORGANIZATAT UDHËHEQËSE:

Habitat for Humanity Macedonia – Skopje



Nikola Parapunov 41, 1000 Shkup, ,
+389 2 306-0890

DETAJET E KONTAKTIT TË PROJEKTIT:


www.habitat.org.mk
www.facebook.com/HFHMacdonia

ORGANIZATAT PARTNERE:

ZBK 'Kreacij'a – Shkup 

Partizanski Odredi 17-3, 1000 Shkup, Maqedoni,
+389 2 321-6903

www.kreacija.org
www.facebook.com/kreacija

RCC 'Drom' – Kumanovë 

Serava 5/7a, 1300 Kumanovë,
+389 31 411-406
www.drom.org.mk

PËRFUNDIMI I SHKOLLËS SI RRUGA DREJT PUNËSIMIT

Numri identifikues i thirrjes: *EuropeAid/136315/ID/ACT/MK*

Numri i kontratës: *12-8409/1*

Kohëzgjatja: *12 muaj*

Periudha: *28.12.2016 – 29.12.2017*

Fusha e politikave: *Përfshirja sociale*

Nën fusha e politikave: *Përfshirja e Romëve në tregun e punës*

Buxheti: *215,342.95 EUR*

Kontributi i BE-së: *199,913.95 EUR*

Qëllimi i Përgjithshëm:

Promovimi i mundësive të barabarta në punësim për gratë dhe burrat romë, duke përkrahur të rriturit romë për ta përfunduar arsimin fillor dhe të mesëm dhe duke i fuqizuar ata për qasje më të mirë në tregun e punës përmes trajnimeve dhe veprimeve të komunitetit.

Target Groupet / Përfituesit:

- 1. 125 të rritur romë, moshë 18-40 vjeç (80% femra) me arsim fillor jo të plotë, që mbulojnë 9 lokalitete.*
- 2. 70 të rritur romë, 18-40 vjeç (37.1% gra) me arsim të mesëm jo të plotë, që mbulojnë 9 lokalitete,*
- 3. Familjet e target grupit, mësuesit dhe administratorët e shkollave nga lokalitetet e përzgjedhura, tregjet lokale të punës dhe bizneset dhe zyrat lokale të punësimi.*

Qëllimet Specifike:

- 1. Rritja e integritit të të rriturve romë në tregun e punës përmes rritjes së zhvillimit të aftësive themelore, edukimit dhe trajnimit me qëllim sigurimin e diplomave të shkollave fillore dhe të mesme.*
- 2. Fuqizimi i grave dhe burrave romë për ta luftuar diskriminimin gjinor dhe etnik në tregun e punës përmes krijimit të grupeve të komunitetit që nxisin edukimin e vazhdueshëm dhe rrugët për punësim.*

Lokacioni i Veprimit:

Tophanë e Romëve në Shkup, Manastir, Prilep, Delçevë, Pehçevë, Berovë dhe Vinicë.



Gratë rome ndjekin seancën e provimeve në gjuhën dhe gramatikën maqedonase.

Rezultatet dhe Aktivitetet e Zbatuara:

- 125 të rritur romë 18-40 vjeç (80% femra) do të marrin diplomën e tyre të arsimit fillor:
 - Organizohet klasa e arsimit fillor për të rriturit në rajonet e synuara.
- 70 të rritur romë të moshës 18-40 vjeç (37.1% femra) do të marrin diplomën e tyre të arsimit të mesëm:
 - Organizohet klasa e arsimit të mesëm për të rriturit në rajonet e synuara.
- Janë krijuar pesë grupetë fuqizimit dhe mbështetjes së komunitetit të përbërë nga së paku 15 pjesëmarrës të shkollave të mesme:
 - Janë organizuar 30 takime dhe punëtori për ta promovuar edukimin e vazhdueshëm dhe rrugët për punësim.
- Minimum 75 të rritur (të paktën 60% femra) do t'i përfundojnë trajnimet për aftësitë e buta dhe trajnimin e kërkimit aktiv të punës:
 - Janë organizuar 60 trajnime për fuqizimin dhe punësimin me qëllim të rritjes së aftësive të buta dhe kërkimit aktiv të punës (komunikimi, menaxhimi i kohës dhe aftësitë e kërkimit të punës).
- Forcimi i bashkëpunimit dhe rritja e rrjetëzimit me zyrat lokale të punës dhe bizneset:
 - Janë organizuar 30 takime dhe punëtori për të promovuar edukimin e vazhdueshëm dhe rrugët për



Gratë rome që praktikojnë intervistë për punë dhe aplikim formal për punë.

Outputet Kryesore / Rezultatet:

1. Rritja e integritit të të rriturve rom në tregun e punës përmes rritjes së zhvillimit të aftësive themelore, edukimit dhe trajnimit me qëllim sigurimin e diplomave të shkollave fillore dhe të mesme.
2. Fuqizimi i grave dhe burrave romë për të luftuar diskriminimin gjinor dhe etnik në tregun e punës përmes krijimit të grupeve të komunitetit që nxisin edukimin e vazhdueshëm dhe rrugët drejt punësimit.

TREGUESIT KRYESORË:

1. Të rriturit romë të moshës 18 deri në 40 vjeç (të paktën 60% femra rome) me arsim fillor të pa kompletuar kanë marrë diplomë për arsim fillor.
 - Targeti: 125. Arritja: 125 (100%)
2. Të rriturit romë të moshës 18 deri në 40 vjeç (të paktën 60% femra rome) me arsim të mesëm të pa kompletuar, përfunduan arsimin e mesëm.
 - Targeti: 70. Arritja: 70 (100%)
3. Janë mbajtur takime / seminare dy mujore që synojnë rritjen e aftësive të buta dhe kërkimin aktiv të punës, nëpërmjet rrjetëzimit dhe përfshirjes aktive të aktorëve lokalë dhe punëdhënësve potencialë.
 - Targeti: 90. Arritja: 90 (100%)
4. Janë themeluar grupet e fuqizimit dhe mbështetjes së komunitetit, të përbërë prej të paktën 15 pjesëmarrës të shkollave të mesme, me theks të veçantë në fuqizimin e grave (të paktën 60% femra).
 - Target:5 Arritja: 5 (100%).

Qëndrueshmëria:

1. Janë lehtësuar takimet ndërmjet grupit mbështetës të komunitetit dhe aktorëve kyç si Agjencia e Punësimit dhe komuniteti i biznesit ndërtojnë një trend dhe traditë të organizimit të takimeve tremujore që do të praktikohen pas mbylljes së projektit, si dhe me qëllim të vëzhgimit të mundësive dhe ofrimit të vendeve të punës.
2. Universiteti i hapur Civil Për Mësim Gjatë Gjithë jetës "VançoPrke" Shtip dhe të tri organizatat partnere të përkushtuara për ta mbështetur dhe përgatitur të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të cilët dëshirojnë të hyjnë në provimin e diplomimit në qershor 2018 pas mbylljes zyrtare të projektit.
3. 30 anëtarë të Komunitetit Rom kanë filluar të përdorin masa aktive për punësim si rezultat i marrëveshjeve të ndjekjes së grupeve të mbështetjes së komunitetit.

"Duke pasur që të dyja, certifikatën për arsimin fillor dhe trajnimin e përfunduar për punësim duhet të jetë një qasje sistematike. Ka shumë gra që kërkojnë të regjistrohen në mes të projektit, sepse ata bëhen të vetëdijshme se kjo mundësi ofron bazë për fillimin e biznesit të tyre "

Ermina Rexhepova, Koordinatorë Lokale, OJQ "Ternipe", Delçevë)



"Tani mendoj se kam vetëbesim më të lartë për t'u ballafaquar si me anëtarët e familjes, por edhe me punëdhënësit të cilët zakonisht i diskriminojnë gratë rome në fillim të aplikimit të tyre për punë".

(Amela Demirova, nxënëse e shkollës fillore, nëna e tre fëmijëve, pjesëmarrëse në trajnimin për punësim dhe fuqizim, Manastir)

Punëtori për kualifikimin e mëtejshëm të të rinjve romë të papunë

ORGANIZATAT UDHËHEQËSE:

Fondi i Edukimit për Romë – Budapest



Terezkr. 46, 1066 Budapest, Hungary
+36 1 235-8030

DETAJET E KONTAKTIT TË PROJEKTIT:

www.romaeducationfund.org

www.facebook.com/RomaEducationFund/

Shoqata për Zhvillimin e Komunitetit Rom 'Sumnal' – Shkup



MaksudSadik bb, 1000 Shkup

+38970699-743

www.sumnal.mk

<https://www.facebook.com/Sumnal-Association-for-development-of-the-Roma-community-in-Macedonia-51109100886/>

Qendra Rome për Kulturë dhe Arsim 'Ternipe' – Delçevë



St. Ilindenskanr. 2, 2320+38978428562; +38933412600

<https://www.facebook.com/ternipemkdelcevo/>

IRHOMTOPAANA – Shkup



BlagojaParović 13-2/9, 1000 Shkup

+38971262-221

www.facebook.com/Association-of-citizens-Irhom-Topaana-267534847042

FUQIZIMI I GRAVE ROME PËRMES KRIJIMIT TË NDËRMARRJEVE SOCIALE

Numri identifikues i thirrjes: *EuropeAid/136315/ID/ACT/MK*

Numri i kontratës: *12-8411/1*

Kohëzgjatja: *12 muaj*

Periudha: *27.12.2016 – 27.12.2017*

Fusha e politikave: *Përfshirja sociale*

Nën fusha e politikave: *Përfshirja e Romëve në tregun e punës*

Buxheti: *125,915.00 EUR*

Kontributi i BE-së: *112,579.80 EUR*

Qëllimi i Përgjithshëm:

Të mbështesë gratë rome për ta rritur pavarësinë e tyre ekonomike duke i ndërtuar dhe rritur aftësitë e tyre të biznesit dhe të jetës duke ju ofruar mundësi punësimi që ato të jenë të vetëmjaftueshme në mënyrë të respektueshme dhe fuqizuese.

Qëllimet Specifike:

- 1. Të rritet mundësia e punësimit të grave rome në sektorin e trajtimeve paliative nëpërmjet promovimit të modelit të ndërmarrjeve sociale.*
- 2. Të forcohen kapacitetet e OShC-ve në krijimin e ndërmarrjeve sociale dhe punësimin e grave rome.*

Target Groupet / Përfituesit:

- 1. Gratë rome.*
- 2. Autoritetet lokale në Shkup.*
- 3. OShC të interesuara për krijimin e ndërmarrjeve sociale.*
- 4. Të moshuarit.*
- 5. Shoqata për Arsime dhe Hulimtim Shëndetësor - HERA.*

Lokacioni i Veprimit:

Shkup.



Gratë rome të angazhuara në Ndërmarrjen Sociale të sapo krijuar "Nega +" në foto sesion për video promovuese.

Rezultatet dhe Aktivitetet e Zbatuara:

1. **20 gra rome janë të trajnuar dhe kualifikuar për ofrimin e kujdesit paliativ:**
 - Punë në Punëtori për integrim,
 - Edukimin në trajtimin paliativ,
 - Themelimi i ndërmarrjeve sociale.
2. **Analizimi situatës dhe plani i biznesit për ndërmarrjet potenciale sociale që mbështesin punësimin e grave rome:**
 - Vlerësimi i nevojave dhe hulumtimi i tregut,
 - Planet e biznesit për OSHC-të
3. **Bashkëpunimi ndërmjet komunës së Qendrës dhe HERA-s drejt krijimit të ndërmarrjeve sociale:**
 - Strategjia e Ndërmarrjeve Shoqërore për Inovacionin me veglën e mikrofinancimit,
 - Ditë informacioni mbi ndërmarrjet sociale dhe stërvitja individuale e OSHC-ve.
4. **80 stafi të OSHC-ve janë trajnuar për zbatimin e strategjisë së ndërmarrjeve sociale që i punësojnë gratë rome:**
 - Organizatat e Shoqërisë Civile krijuan plane biznesi dhe krijuan shoqëri sociale që punësojnë gra rome.
5. **OSHC-të kanë njohuri dhe kapacitete të përpilojnë dhe krijojnë ndërmarrje shoqërore:**
 - Trajnime në sipërmarrjen sociale,
 - Udhëzues i Ndërmarrjeve Sociale.



Info ditët, mars 2017, EU Info Qendra – Shkup.

Outputet Kryesore / Rezultatet:

1. 4 ditë informacioni.
2. Manual për organizatat joqeveritare që dëshirojnë të themelojnë ndërmarrje shoqërore për punësimin e personave në nevojë (ISBN 978-608-4598-77-0; <http://bit.ly/2xlqFGm>).
3. Subdomain i Projektit <http://bit.ly/2kSGRnf>.
4. Projekti faqja e Facebookut <https://www.facebook.com/otvoramemoznosti/>.
5. Publikimi: Analiza e Nevojave për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Maqedonisë (ISBN 978-608-4598-85-5; <http://bit.ly/2gJB719>).
6. 4 Integrimi në Punë Trajnime Profesionale për Gratë Rome.
7. 4 Punëtori për zhvillimin e biznesit social për OSHC-të.
8. 16 Plane të Biznesit të zhvilluara nga OSHC-të.
9. Trajnimi pasues për Plani të Biznesit dhe Zhvillimin e Kërkimit të Tregut.
10. 10 gra rome morën certifikata për programin e përfunduar me sukses në kujdesin paliativ profesional.
11. Hulumtimi i tregut për 'Nega +'.
12. Themelohet Ndërmarrja sociale 'Nega +' <http://bit.ly/2zbvQAO>; <http://bit.ly/2fytpck>; <http://bit.ly/2xllciL>.

Treguesit kryesor:

1. % e femrave rome që kanë përfunduar trajnimin profesional.
 - 43 gra ose 53.75%.
2. % e grave rome morën certifikata për kujdesin paliativ dhe u punësuan.
 - 10 gra morën certifikata ose 50%; 10 gra janë punësuar ose 100%.
3. % e grave rome të angazhuara në ndërmarrjen sociale në kujdesin paliativ.
 - 10 gra ose 100%
4. Numri i OSHC-ve që punojnë me romët të trajnuar në krijimin e ndërmarrjeve sociale.
 - 56 personel të OShC-ve të trajnuar ose 70%.
5. Numri i OSHC-ve të që krijuan ndërmarrjet shoqërore që punësojnë gratë rome.
 - 1 OShC ose 100%

Qëndrueshmëria:

1. Marrja e lokaleve (zyra administrative) nga Komuna e Qendrës për 'Nega +'.
2. Politikat lokale për sipërmarrjen sociale të zhvilluara bashkërisht me autoritetet lokale.
3. Vegëlmikrofinanciare për mundësimin e mjedisit financiar të OSHC-ve të gatshëm për të krijuar ndërmarrje shoqërore të zhvilluara, të gatshme për avokim të mëtejshëm në sektorin e korporatave / bankave.



Trajnimi në Konceptin e Ndërmarrjeve Shoqërore, qershor 2017, Hotel Arka - Shkup.

"Kemi punuar shumë me ekipin" Nega + "për katër muaj. Ky trajnim dëshmoi edhe një herë se profesionalizmi nuk është i lidhur me sfondin etnik, ngjyrën e lëkurës apo statusin shoqëror, e gjitha që duhet është dashuria e madhe për këtë punë".

(StankaBozhinovska, Specialiste e Infermierisë, Trajner në OJQ 'Humanost')

"Kjo ndërmarrje është e ndryshme nga format tradicionale të ndërmarrjeve në atë që udhëhiqet nga misioni i saj shoqëror, e cila mbështet dhe ndihmon gratë romë në punësimin e tyre. Fitimi i krijuar nga ndërmarrja është e dedikuar ekskluzivisht për mbulimin e të ardhurave mujore të grave romë të punësuar dhe për kostot operacionale të nevojshme për ofrimin cilësor të këtyre shërbimeve."

(BlagicaPetrova, Sipërmarrëse Sociale, Nega +)

"Isha duke kërkuar punë për një kohë shumë të gjatë dhe nuk mund të gjeja asnjë. U bashkova me Nega +, mori diplomë ndëhetanijam e gatshmetë jap kujdes të piak për të moshuarit".

(IdafeteBerisha, kujdestare, Nega +)

ORGANIZATAT UDHËHEQËSE:

Shoqatapër Edukimin dhe Kërkim Shëndetësor H.E.R.A.

- Shkup  

Ruzveltova 51a, 1000 Shkup

+389 2 3290 395

www.hera.org.mk

DETAJET E KONTAKTIT TË PROJEKTIT:

socialnopretpriemnistvo.hera.org.mk

www.facebook.com/otvoramemoznosti

ORGANIZATAT PARTNERE:

Insertion et Alternatives Group SOS – Paris 

102C rue Amelot, 7 boulevard Voltaire, 75011 Paris, France

+775 685 506 00872

www.facebook.com/LeComptoirDeLInnovation

Komuna Qendr - Shkup 

Mihail Çokovpn, 1000 Shkup

+389 2 3203 602

www.centar.gov.mk

NGRITJA! - PËRFSHIRJA E ROMËVE PËRMES SIPËRMARRJES SOCIALE

Numri identifikues i thirrjes: *EuropeAid/136315/ID/ACT/MK* Fusha e politikave: *Përfshirja sociale*

Numri i kontratës: *12-8412/1*

Kohëzgjatja: *12 muaj*

Periudha: *28.12.2016 – 27.12.2017*

Nën fusha e politikave: *Përfshirja e Romëve në tregun e punës*

Buxheti: *192,625 EUR*

Kontributi i BE-së: *182,988 EUR*

Qëllimi i Përgjithshëm:

Për ta nxitur përfshirjen sociale të romëve të rinj përmes edukimit të sipërmarrjes sociale. Projekti ka për qëllim t'i fuqizojë romët për t'u bërë akterë aktivë të shoqërisë përmes hyrjes në fushën e sipërmarrjes shoqërore dhe për të krijuar mjedis për zhvillimin e sipërmarrjes shoqërore përfshirëse rinore.

Lokacioni i veprimit:

- 1. Shkup dhe Shtip - krijimi i SS Qendrave dhe punëtori 5-ditore të qëndrueshmërisë.*
- 2. Shkup, Shtip, Kumanovë, Manastir dhe Strumicë - Trajnime 3-ditore në SS.*
- 3. Shkup - TiT (Trajnimi i trajnerëve) dhe SS konkurrenca;
Në nivel nacional - ngjarje të shumta promovuese*

Qëllimet Specifike:

- 1. Të ofrohen trajnime të përshtatura për zhvillimin e sipërmarrjes sociale për romët dhe NEETs.*
- 2. Themelimi i qendrave të sipërmarrjeve sociale në Shkup dhe Shtip për mbështetjen e sipërmarrësve të rinj me fokus në grupet e pafavorizuara të të rinjve.*
- 3. Të organizohet SE konkurrencë, ku pjesëmarrësit do t'i zbatojnë njohuritë e tyre në praktikë.*
- 4. Të fillohet një fushatë ndërgjegjësimi për integrimin e romëve përmes sipërmarrjes sociale.*
- 5. Të përfshijë aktorët kryesorë në vend për përkrahjen afatgjatë të Qendrave të Informacionit.*

Target Grupet / Përfituesit:

Përfaqësuesit e rinj të papunë nga pakica rome dhe të rinjtë e tjerë të pafavorizuar, sidomos NPAT (nuk janë në punësim, arsim apo trajnim).



Promovimi i projektit dhe konkurrenca e SS në trajnim tre ditor në Manastir 27-29.06.2017.

Rezultatet dhe Aktivitetet e Zbatuara:

1. **Rritja e nivelit të shkathtësive, njohurive dhe përvojës në sipërmarrje dhe sipërmarrjen sociale:**
 - VNT (Vlerësimi i Nevojave të Trajnimit) dhe zhvillimi i një metodologjie trajnimi të përshtatur,
 - Përzgjedhja e trajnerëve dhe TiT (Trajnimi i trajnerëve),
 - Zbatimi i gjashtë trajnimeve 3-ditore me 180 të pjesëmarrës romë.
2. **Krijimi i SS Qendrave në Shkup dhe Shtip:**
 - Organizimi i objekteve dhe pajisjeve; rekrutimi i punonjësve dhe vullnetarëve,
 - Zhvillimi i një Plani Strategjik të Punës për SSQendrat.
3. **Janë zhvilluar të paktën dhjetë SS ide biznesi:**
 - Organizimi dhe promovimi i konkurrencës SS,
 - Përzgjedhja e propozimeve më të mira dhe shpërblimi i tri vendeve të para.
4. **Ngritja e vetëdijes për integrimin e romëve dhe vetëpunësimin përmes sipërmarrësisë sociale:**
 - Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve promovuese në internet dhe ato të shtypura,
 - Evenimente të shumëfishta të informimit dhe promovimit,
 - Aktivitetet e shpërndarjes, zhvillimi i faqes së internetit dhe kanaleve të mediave sociale.



1: Takimi i komunitetit dhe promovimi i projektit, Shtip 19.05.2017; 2: Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me palët e interesuara.

Outputet Kryesore / Rezultatet:

- VNT (Vlerësimi i Nevojave të Trajnimit). Pyetësori i VNT; studim paraprak; Raporti i VNT.
- Moduli i Trajnimit. Materialet për TiT dhe trajnimet; 12 trajnues në TiT morën certifikata; 180 trajnues në trajnimet 3-ditore morën certifikata.
- Strategjia e Qendrës SS për Qëndrueshmëri. Plani Strategjik i Punës dhe Plani i Veprimit.
- Strategjia e Promovimit dhe Shpërndarjes. Fletëpalosjet e projektit, banderola, broshura, materiale promovuese me logo të shtypur të projektit, 6 gazeta, postimemediale dhe njoftime për shtyp; gazeta "Trajtimi i përfshirjes sociale të romëve dhe marginalizimi me sipërmarrjen sociale" të paraqitura për botim në gazetën akademike "Mendimi ekonomik dhe praktika" ("Ekonomskamisao i praksa"), që do të publikohet si pjesë e botimit të dhjetorit 2017.

Treguesit Kryesor:

1. **Moduli i trajnimit u testua me sukses gjatë TiT.**
 - Arritja 100% (të gjithë 12 pjesëmarrësit e vlerësuan pozitivisht).
2. **U hapën 2 qendra sociale dhe filluan aktivitetin.**
 - Arritja 100% (Qendrat e SS në Shkup dhe Shtip janë plotësisht funksionale).
3. **2 qendra ofruan 4 vendosje pune.**
 - Arritja 100% (Qendrat e SS të mbushura me personel që nga fillimi i projektit).
4. **2 qendra ofruan 10 vendosje vullnetare.**
 - Arritja 100% (Ky indikator do të tejkalohet për kohën e përfundimit të projektit).
5. **180 të rinj marrin pjesë në trajnime me sukses dhe plotësisht.**
 - Arritja 100%.
6. **Më shumë se 10 ide të paraqitura dhe të vlerësuara nga projekti.**
 - Ky indikator do të tejkalohet; deri tani janë dorëzuar më shumë se 10 ide.

Qëndrueshmëria:

Shtyllat kryesore për sigurimin e qëndrueshmërisë së projektit janë SS Qendrat që do të mbeten aktive, të arritshme dhe të hapura për përfshirje pas përfundimit të projektit.

1. *Stafi i Qendrës janë trajnuar përmes punëtorive të qëndrueshmërisë 5-ditore.*
2. *Është zhvilluar Plani Strategjik i Punës për Qendrat SS, duke përfshirë planin e detajuar të Veprimit për vitin e ardhshëm (2018).*
3. *Janë krijuar lidhje me aktorë të ndryshëm dhe janë nënshkruar memorandume mirëkuptimi.*



Promovimi i Strategjisë së Sipërmarrësisë për Romët në Manastir, 25.08.2017.

"Ky projekt adreson marginalizimin dhe mungesën e shkathtësive të punësimit dhe vetëpunësimit të komunitetit rom në vend përmes edukimit të sipërmarrjes sociale, duke krijuar një ambient për zhvillimin e mëtejshëm përfshirës të të rinjve".

(Erol Ademov, Kryetar i Shoqatës së Shoqërisë Multietnike për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrtar i Lartë për Marrëdhëniet me Komunitetet në Komunën e Shtipit, aktor në takimet e komunitetit dhe trajner në trajnimet 3-ditore)

"Trajnimi më dha njohuri të reja rreth sipërmarrësisë sociale, si dhe aftësi të vlefshme për zhvillimin e mëtejshëm dhe zbatimin praktik të ideve të mia për biznes".
(Gari Muslievski, trajnues në trajnimin 3-ditor në Kumanovë)

ORGANIZATAT UDHËHEQËSE

National Centre for Development of Innovation and Entrepreneurial Learning – Skopje

Dame Gruev 1/2-17, 1000 Skopje,

+389 2 309-9481

www.ncdiel.mk

www.facebook.com/NCDIEL.Skopje

<https://www.facebook.com/NCDIEL.Skopje>

DETAJET E KONTAKTIT TË PROJEKTIT:

www.rise.org.mk

www.facebook.com/RISE.org.mk

www.twitter.com/RISE_org_mk

ORGANIZATA PARTNERE:

YouNet – Bologna, Italy

Via dello Scalo 21/3, 40126 Bologna, Italy

www.you-net.eu

www.facebook.com/younetit

www.twitter.com/YouNet



PUNËSIM PËR ROMËT E RINJ

Numri identifikues i thirrjes: *EuropeAid/136315/ID/ACT/MK*

Fusha e politikave: *Përfshirja sociale*

Numri i kontratës: *12-8413/1*

Nën fusha e politikave: *Përfshirja e Romëve në tregun e punës*

Kohëzgjatja: *12 muaj*

Buxheti: *158.297,34 EUR*

Periudha : *27.12.2016 – 26 .12.2017*

Kontributi i BE-së: *150.382,47 EUR*

Qëllimi i Përgjithshëm:

Lehtësimi i përfshirjes së të rinjve romë në tregun e punës që jetojnë në komunat me popullsi të konsiderueshme romë.



Qëllimet Specifike:

- 1. Rritja e aftësive dhe kuptimi i punësimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës nëpër komuna.*
- 2. Ndërtimi të një sistemi lokal për zhvillimin e fuqisë punëtore.*
- 3. Zhvillimi i udhëzuesit strategjik lokal për përfshirjen sociale në tregun e punës të target grupit.*

Target Grupet / Përfituesit:

- 1. Të rinjtë romë të papunë (mosha 15-35 vjeç) që jetojnë në Shkup, Koçan, Tetovë dhe Manastir.*
- 2. Komunat e Shkupit, Koçanit, Tetovës dhe Manastirit; MPPS, ZHEL (MLSP, LED) dhe sektori i shoqërisë civile në komunat e synuara; biznes sektori, Agjencia e Punësimit.*

Lokacioni i Veprimit:

Komunat e Shkupit, Koçanit, Tetovës dhe Manastirit.



Vendosja praktike e të trajnuarve në OSHC Sumnal - Manastir, CEA - Shkup, BamikaMedika - Tetovë, Avokati Vladimir Petkovski - Manastir dhe Merkator - Koçan.

Rezultatet dhe Aktivitetet e Zbatuara:

- Janë përkufizuar boshllëqet midis nevojave të tregut të punës dhe aftësive ekzistuese të punës dhe lehtësimin e mundësive për "përshtatjen e punës" midis punëdhënësve dhe të rinjve romë si punonjës potencialë:
 - o Studim kërkimor mbi tregun e punës në komunat e synuara,
 - o Profilizimi i karakteristikave të targetgrurit,
 - o Katër Ngjarje Promocionale për përputhjen e ofruesve të punëdhënësve / trajnimeve dhe punonjësve / trajnerëve potencialë.
- Themelimi i sistemit për zhvillimin e aftësive personale, të kryera trajnimet me porosi për segmente specifike të targetgrupeve dhe programit praktik të trajnimit dhe punësimit kalimtar:
 - o Vendosja e 4 pikave të punësimit,
 - o Identifikimi i pjesëmarrësve të target grupit,
 - o Zbatimi i trajnimit i bazuar në gjetjet,
 - o Mundësimi i trajnimit praktik në sektorin e biznesit / OJQ-ve,
 - o Ofrimi i punësimit / trajnimit kalimtar.
- Analiza e sistemit aktual për përfshirjen sociale të targetgrurit të përgatitur dhe Udhëzuesi Strategjik Lokal, plani i veprimit të zhvilluar:
 - o Analiza e shërbimeve të tregut të punës, politikave nacionale dhe lokale dhe stimujve relevantë ndaj nevojave të punësimit të popullatës së synuar,
 - o Zhvillimi i Udhëzuesit Strategjik dhe planit të veprimit për përfshirjen e rinisë romë në tregun e punës (në vazhdim, do të zhvillohet në mes të nëntorit).
- Rritja e ndërgjegjësimit midis targetgrurit dhe aktorëve të tjerë të Aktiviteteve të Veprimit dhe ngritjen sensibilizimit publik nga nevoja për përfshirjen sociale të të rinjve nëpërmjet punësimit:
 - o Katër Ngjarje Promovuese dhe promovimi i materialit promovues për vizibilitet të aktivitetit,
 - o Konferencë për shtyp për aktivitetet e Veprimit dhe Strategjisë Lokale (në vazhdim),



1: Ngjarje promovuese në Manastir; 2: Promovimi në Koçan; 3: Sesioni i trajnimit 2 - Aftësitë ndërpersonale dhe të buta; 4: Sesioni i trajnimit 4 - Qasja në Financim.

Outputet Kryesore / Rezultatet:

- Studimi i nevojave të tregut të punës në komunat e synuara, Karakteristikat e kërkesës së punës: ndërmarrjet e vogla dhe mikro (ISBN 978-608-4731-31-3; <http://cea.org.mk/wp-content/uploads/2017/05/1.-Business-Labor-Demand-Emplyment-Roma-Wo-logo-WCip.pdf>).
- Profilizimi i karakteristikave të target grupit, Profili i të rinjve romë të papunë nga Shkupi, Manastiri, Koçani dhe Tetova (ISBN 978-608-4731-32-0; <http://cea.org.mk/wp-content/uploads/2017/05/Profile-Labor-Supply-.1.pdf>)
- Analizat e shërbimeve të tregut të punës, politikave nacionale dhe lokale dhe stimujve relevantë për nevojat e punësimit të popullatës së synuar (ISBN 978-608-4731-35-1; <http://cea.org.mk/wp-content/uploads/2017/09/Analiza-na-nacionalnite-uslugi-i-politiki-za-socijalna-zastita-.pdf>).
- Udhëzuesi Strategjik Lokal dhe Plani i Veprimit për përfshirjen sociale dhe të tregut të punës të të rinjve romë (në vazhdim).

Treguesit kryesor:

- Targeti: 40 intervista me bizneset në Shkup, Tetovë, Koçan dhe Manastir. Arritja: 40 (100%).
- Targeti: 80 intervista me përfaqësuesit. Arritja: 85(106%).
- Targeti: 20 përfaqësues nga sektori i biznesit lokal në ngjarje promovuese. Arritja: 22 (110%).
- Targeti: 4 ngjarje promovimi. Arritja: 4, (100%).
- Targeti: 80 të rinj të papunë romë për sesionin e trajnimit. Arritja: (79, 99%).
- Targeti: 20 të rinj romë për trajnime në OShC. Arritja: 15 (75%) (në vazhdim).
- Targeti: 20 të rinj romë për trajnime në sektorin e biznesit. Arritja: 15 (750%) (në vazhdim).

Qëndrueshmëria:

1. Përgatitja, paraqitja e dokumenteve strategjike rajonale dhe planeve të veprimit të cilat mund të përdoren nga aktorë të ndryshëm (në vazhdim).
2. Të pajisur dhe pajisjet e transferuara për operacione të mëtejshme në organizatat partnere.
3. Veprime të vazhdueshme për rritjen e punësimit të romët e rinj.



Palët e interesuara diskutojnë dhe informojnë për qëllimin dhe qëllimet e projektit, Koçan.



"Do të doja të theksoja dhe do të avokoj fuqishëm që stazhi që do të kryhet në sektorin e biznesit dhe OSHC-të lokale brenda Komunës së Koçanit do të jetë me rëndësi vendimtare për të rinjtë romë të papunë ku do të kenë mundësi të jenë pjesë e projektit dhe të fitojnë përvojë dhe aftësi praktike. Nga këndvështrimi im, ka një interes të madh, sidomos nga të rinjtë romë në moshën 20-25 vjeçare për stazh me mundësi punësimi në të ardhmen".

(Manueala Saidova, Mentor Lokal në OSHC 'Svetlaldnina' nga Koçani, pjesë e projektit)

"Dua të theksoj se ndihem i privilegjuar që jam zgjedhur si praktikant dhe isha pjesë e programit të praktikës përmes projektit Punësimi për Rininë Rome në OSHC - CEA në Shkup. Kjo praktikë më ndihmoi të njihesha me programin SPSS dhe me mundësitë e ofruara nga programi përmes ushtrimeve të programit për qëllimet e hulumtimit që punoja. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për mua në mënyrë që të përmirësoj njohuritë e mia teknike dhe statistikore. Për më tepër, unë kam mësuar se si të organizoj dhe cilat qasje për ti përdornë hulumtimet në terren. Me siguri mund të them se pas 2 muaj praktikë kam fituar më shumë besim dhe njohuri më të mirë në fushën e shkrimit të letrave për qëllime kërkimore".

(Elson Iljaz, praktikant në Qendrën për Analiza Ekonomike në Shkup)

ORGANIZATAT UDHËHEQËSE:

Qendra për Analiza Ekonomike - Shkup



Jane Sandanski 63/3, 1000 Skopje

+389 2 244-4766

www.cea.org.mk

www.facebook.com/ceaorgmk/

DETAJET E KONTAKTIT TË PROJEKTIT:

www.facebook.com/romayouth/

ORGANIZATAT PARTNERE:

Shoqata e Zhvillimit Demokratik të Romëve 'Sonce' – Tetovë



Ivo Ribar Lola 381/3, 1200 Tetovë

+389 44 352-391

www.sonce.org.mk

Shoqata për Zhvillimin e Komunitetit Rom 'Sumnal' – Manastir



Dimitar Vlahov 22, 7000 Manastir

+389 78 421-182

www.sumnal.mk

Center for Culture, Communication and Education of the Roma 'Svetlaldnina' – Koçan



Veljko Vlahović 46, 2300 Koçan

+389 33 272-253

Fuqizimi i aktorëve përkatës në fushën e përfshirjes sociale

PASE - PLATFORMA E NDIHMËS SOCIALE DHE EKONOMIKE E KOMUNËS ÇAIR

Numri identifikues i thirrjes: *EuropeAid/135012/M/ACT/MK*

Numri identifikues i thirrjes: *12-9144/1*

Kohëzgjatja: *20 muaj*

Periudha: *14.12.2015 – 14.08.2017*

Fusha e politikave: *Përfshirja Sociale"*

Nën fusha e politikave: *Fuqizimi i aktorëve përkatës në fushën e përfshirjes sociale*

Buxheti: *145,153.95EUR*

Kontributi i BE-së: *137,896.26 EUR*

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM:

Kontributi në përfshirjen më të madhe sociale dhe ekonomike të grupeve të cenueshme në nivel komunal, me qëllim të arritjes së zvogëlimit të varfërisë, nivelit të papunësisë dhe standardit të përmirësuar të jetesës për grupet e cenueshme në Komunën e Çairit.

QËLLIMET SPECIFIKE:

*Të promovohet një model ndër-sektorial i përfshirjes sociale dhe ekonomike për grupet e cenueshme në Komunën Çair, me qëllim të përmirësimit të kapacitetit të aktorëve lokalë të angazhuar në identifikimin e grupeve të prekshme në rrezik të përjashtimit social dhe ekonomik në Komunën Çair.
Të adaptojë një përfaqje strategjike dhe me shumë aktorë për përfshirjen sociale dhe ekonomike të grupeve të cenueshme në Komunën Çair.
Të zhvillojë dhe të pilotojë modelin udhëzues social dhe ekonomik për grupet e cenueshme në Komunën Çair.*

TARGET GRUPET / PËRFITUESIT:

*Profesionistë nga Komuna e Çairit.
Qendra për Punë Sociale, Agjencia për Punësim.
OJQ lokale.
Grupet e rrezikuara që jetojnë në Komunën e Çairit.*

LOKACIONI I VEPRIMIT:

Komunën e Çairit, Qytetii Shkupit.



1: Trajnimi i anëtarit të PASE në partneritetet ndërsektoriale; 2: Përgatitja e Strategjisë për përfshirje sociale për komunën.

REZULTATET DHE AKTIVITETET E ZBATUARA:

1. *Zhvillimi i mekanizmit konsultativ për rritjen e përfshirjes sociale dhe ekonomike të grupeve vulnerabël:*
 - o *Takimet midis palëve të interesuara, formimin e një Platforme lokale për Ndihmë Sociale dhe Ekonomike - PNSE,*
 - o *Zhvillimi i programeve trajnuese për ekspertët nga PNSE, Zbatimi i trajnimit për PNSE për asistencën e grupeve të cenueshme në Komunën e Çairit.*
2. *Përmirësimi i qasjes strategjike për rritjen e përfshirjes sociale dhe ekonomike të grupeve të cenueshme:*
 - o *Analiza e të dhënave në dispozicion për përfshirjen sociale dhe ekonomike dhe profilizimin e grupeve të cenuara në Komunën e Çairit,*
 - o *Miratimi i Strategjisë për Përfshirjen Shoqërore dhe Ekonomike të grupeve të cenueshme në Komunën Çair.*
3. *U promovua një program pilot i ndihmës sociale dhe ekonomike për grupet e cenuara në nivel komunal:*
 - o *Dizajnimi dhe nisja e portalit PNSE për lidhjen e grupeve të cenuara në Komunën e Çairit,*
 - o *Hapja e linjës ndihmëse të PNSE për udhëheqjen e grupeve të cenuara në Çair për asistencë socio-ekonomike,*
 - o *Formimi i ekipeve mobile të PNSE për ofrimin e udhëzimeve sociale dhe ekonomike për grupet e cenuara në Komunën Çair.*



Këshillim individual për zhvillimin e planeve personale për karrierë me përfaqësues së target grupit.

OUTPUTET KRYESORE / REZULTATET:

- 1. *Platforma e Ndihmës Sociale dhe Ekonomike si pjesë e një mekanizmi inovativ ndërsektorial për adresimin e nevojave të grupeve të cenuara në Komunën e Çairit.*
- 2. *Është miratuar 1 strategji për përfshirjen sociale dhe ekonomike të grupeve të cenuara në Komunën e Çairit bazuar në nevojat e identifikuara dhe profilizimin e grupeve të ndryshme të cenuara, që të përfshihen në targetin strategjik të institucioneve përgjegjëse në nivel lokal dhe kombëtar.*
- 3. *Është promovuar 1 model i udhëzimit social dhe ekonomik për grupet e cenuara në Komunën e Çairit: ndërhyrje inovative, siç janë ekipet mobile, ueb portali dhe linjë telefonike për adresimin e nevojave të grupeve të cenuara për përfshirjen sociale (dhe informacion për punësim).*
- 4. *Grupet e cenuara të ndihmuara në Komunën e Çairit për përfshirjen sociale dhe ofrimin e rrugëve për (vetë) punësim duke promovuar përfitimet sociale dhe programet e punësimit ekzistues si dhe informacione mbi detyrimet e tjera ligjore, tatimore dhe socio-ekonomike ndaj autoriteteve.*

Treguesit kryesor:

1. *Numri i takimeve të rregullta brenda platformës PNSE.*
Targeti: 48. Arritja: 22 (45.8%).
Numri i platformës ndër-sektoriale të formuara: Platforma e Ndihmës Sociale dhe Ekonomike – PNSE (Komuna e Çairit, Qendra Ndër-Komunale për Punë Sociale Shkup, Agjencia për Punësim dhe OJQ-të).
 - o *Targeti: 1. Arritja: 1 (100%).**Numri i anëtarëve në platformën PNSE.*
 - o *Targeti: 40. Arritja: 55 (137.5%).**Numri i programeve të trajnimit të zhvilluara për anëtarët e PNSE: 1) për lehtësimin e partneriteteve ndërsektoriale dhe 2) për ndërveprim me grupet e cenueshme.*
 - o *Targeti: 2 (1+1). Arritja: 2 (1+1) (100%).*
 5. *Numri i paketave të trajnimit të zhvilluara së bashku me referencat dhe mjetet për trajnerët; numri i trajnerëve të zgjedhur për të ofruar trajnimet.*
 - o *Targeti: 2+2. Arritja: 2+2 (100%).*
 6. *Numri i trajnimeve tre-ditore për anëtarët e PNSE për lehtësimin e partneriteteve ndërsektoriale dhe ndërveprimin me grupet në nevojë.*
 - o *Targeti: 2. Arritja: 2 (100%).*
 7. *Numri i anëtarëve të trajnuar të PNSE.*
 - o *Targeti: 40. Arritja: 36 (81%).*

QËNDRUESHMËRIA:

